

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7654 E hënë 17 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Reportazhi

Ditës

Nga MONIKA STAFA

**K**ërkoja më kot të hidhja sytë mbi bibliotekë për të dalluar se cilin libër do të merrja me vete në këtë udhëtim për të disatën herë në kryeqytetin çek ...  
Vijon në faqen 20

Praga, tundimi për të jetuar ende në shekullin e alkimistëve



Opinion

Ditës

Nga PËRPARIM KABO

**U**mbush një dekadë nga shpërthimi i krizës financiare, bankare dhe monetare, e cila tronditi nga themelet jo vetëm institucionet që menaxhojnë ...  
Vijon në faqen 21

10 vjet nga kriza financiare, pyetjet mbeten pezull ...!



Shërbimet mjekësore që marrin falas të moshuarit

## Pensionistët, ja përfitimet nga sigurimi shëndetësor dhe kategoritë

FSDKSH: Barnat me rimbursim, kush mund t'i marrë falas ose me 50% zbritje

VOLTIZA DURO

Qytetarët që paguajnë kontributet për sigurimet shëndetësore, iu lind e drejta e përfitimit të rimbursimit të barnave si dhe mund të marrin disa shërbime mjekësore falas. 'Gazeta Shqiptare' zbarch sot përfitimet që ...  
Në faqen 9

## 75-VJETORI I ÇLIRIMIT TE TEPELENES, TRITAN SHEHU: RAMA TE SHKARKOJE KRYEBASHKIAKUN

# TERMET PEÇI I KENDON ENVERIT: O KAPEDAN..

Reagon kryetari i bashkisë: Le të më heqin. Kreu i Institutit të të Përndjekurve: Jemi të shokuar. Edhe në Pezë rikthehen nostalgjikët me fotot e diktatorit



(Në foto) Simbole komuniste dhe në Pezë. Termet Peçi gjatë festimeve të 75-vjetorit të çlirimit të Tepelenës



Në faqen 2-3

ALEANCA E RE

**PD-PDIU bashkë, Basha: Fund qeverisë së krimit, dakordësi me Dulen**

Në faqen 5

INTERVISTA

**Integrimi, Meta: BE të shohë progresin e bërë nga Shqipëria. Të hapen bisedimet**

Në faqen 4

YLLI POLOVINA

**Konferenca e Pezës dhe çanta e fryrë e Enver Hoxhës. Disa të dhëna ndryshe**

Në faqen 10-11

AKUZAT NDAJ GRUPIT

**Gjykata e Krujës në burg 4 të 'fortët' e Niklës. Lutfi Haka në "arrest shtëpie"**

Në faqen 7

DERMATOLOGIA LAÇKA: SI T'I TRAJTONI FLOKET



**Mjeku popullor Ylli Merja: Kura me bimë medicinale që ndalon virozat**

Suplement

I internuari 5 vjet në Tepelenë: Pëllumb Xhufi, historian qorr i oborrit të vjetër

## "Ju tregoj persekucionin 45-vjeçar që iu bë Vermoshit"

Nikoll Hysaj: Zotërinj historianë, thoni të vërtetën për krimet e komunizmit

NGA NIKOLL PJETËR HYSAJ

Jetoj prej 38 vjetësh në shtetin e Miçiganit në USA. Në të kaluarën dhe aktualisht kam ndjekur dhe ndjek me vëmendje të gjitha zhvillimet politiko-ekonomike dhe shoqërore të trevave shqiptare. Para viteve 1990 emigrantët



shqiptarë, veçanërisht në të larguarit nga Shqipëria për motive politike, kishin shumë vështirësi për t'u lidhur me familjet e të afërmit që kishin lenë në At dhe. Këto vështirësi e të tjera vinin nga fakti i vetëizolimit dhe diktatura që konsolidoi ...

Në faqen 18-19

## SIMBOLET E KOMUNIZMIT PERPLASJA

Aktiviteti për 76-vjetorin e Konferencës, Hysi: Hodhi themelet e unitetit të shqiptarëve

# Konferenca e Pezës, komunistët kujtojnë me pankarta Enver Hoxhën

## Nostalgjikët: "Rroftë Partia Komuniste"

Valentina Madani

Tirana përkujtoi dje 76-vjetorin e Konferencës së Pezës, një prej ngjarjeve më të rëndësishme të popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore, për bashkimin e shqiptarëve kundër pushtuesve. Veteranë luftime, përfaqësues të ekzekutivit, deputetë e drejtues të pushtetit vendor, nderuan veprën dhe sakrificën e të gjithë të rinjve e të reja që u bashkuan kauzës së luftës për çlirimin e vendit. Por sërish dje në Pezë u shfaqën nostalgjikët e ish-diktatorit Hoxha. Anëtarë të Partisë Komuniste nderuan dëshmorët duke mbajtur pankarta dhe foto të ish-diktatorit Enver Hoxha. Nostalgjikët e diktatorit parakaluan në Pezë, ndërsa lëshonin thirrje për Hoxhën. "Rroftë Partia Komuniste", "Enver Hoxha", këto janë disa nga thirrjet e tyre. Skena të tilla organizohen çdo vit në Pezë. Në 16 shtator 1942 delegatë dhe përfaqësues të krahinave të ndryshme u mbledhën në Pezë me qëllim organizimin e forcave të ndryshme politike në luftën kundër Italisë fashiste. Drejtues të pushtetit vendor dhe ata qendror kryen homazhe në Varrezat e Dëshmorëve. Nënkrjetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Vasilika Hysi zhvilloi homazhe në varrezat e dëshmorëve në Pezë dhe para memorialit të patriotit, Myslym Peza si dhe vendosi një kurorë me lule. "Peza është pa asnjë dyshim vendi më i përshtatshëm dhe më i bukur për të revokuar e kremtuar Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Dëshiroj gjithashtu të shpreh mirënjohjen e të gjithë shqiptarëve për luftëtarët e lirisë, që këtu në Pezë ndëruan themelet e unitetit e të bashkimit të shqiptarëve "Pa dallim klase, feje, krahine dhe ideje", duke u mbështetur në devizën e rilindësve "Feja e shqiptarit është shqiptaria", theksoi Hysi. "Ky emër, ky fshat, kjo shtetëri që kemi përballë dhe mbi të gjitha njerëzit e saj, na ngjallin të gjithëve emocionet dhe na krijojnë të



Nënkrjetarja e Kuvendit Vasilika Hysi

gjithëve frymëzim. Na motivojnë të gjithëve për ta dashur më shumë Shqipërinë, për të punuar më shumë bashkërisht. Peza na frymëzon për të bërë punë edhe më të mira për Shqipërinë", tha Hysi. Por, nënvizoi ajo, "Peza na qorton kur interesat politike i vendosim përmbi interesin kombëtar". Dhe interesi ynë më i madh kombëtar në ditët e sotme, theksoi Hysi, është

ta bëjmë Shqipërinë politiki dhe juridiki ashtu siç është në frymën dhe shpirtin e çdo shqiptari: Një Shqipëri europiane, anëtare të Bashkimit Europian, familjes më të madhe demokratike të botës së sotme, me mbi gjysmë miliardë banorë, të kësaj familjeje, e cila bashkë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës përbëjnë dy

pjesët më të zhvilluara, më të ndriçuara dhe më të begata të qytetërimit perëndimor". "Por përparimi i Shqipërisë është i mundshëm dhe i arritshëm vetëm nëse bëhemi bashkë për të çuar deri në fund reformat e thella që kërkojnë nevojat e zhvillimit, por edhe partnerët tanë ndërkombëtarë", theksoi nënkryetarja e Kuvendit.

## Bashkia homazhe në 'Varrezat e Dëshmorëve'

### Veliaj: Kacafytemi kundër njëri-tjetrit, të shpëtojme Shqipërinë

Bashkia e Tiranës organi zoi dje aktivitetet muzikore dhe panairë për të kthyer Pezën në një destinacion feste për të gjithë qytetarët. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj theksoi rëndësinë e kujtim-it të kësaj ngjarje dhe të mesazheve që ajo përcjell edhe tek brezat e tjerë. Ai nënvizoi se Konferenca e Pezës është një mësim i madh për të gjithë shqiptarët për të mos penguar njëri-tjetrin, por për të punuar së bashku për progresin. "Po ndërtojmë sot shtet, po ndërtojmë qytet, që kur të shkruajmë historia pas 76 viteve, të themi: Po,




ne ishim në anën e duhur, siç ishim 76 vite më parë në anën e duhur të historisë. Bashkëpunuar që Shqipëria të ecë përpara. Por, pyetja është kjo: A po e bëjmë këtë të gjithë? Mendoni se do të shkruajmë njëri pas 76 vitesh historinë sesi shajmë njëri-tjetrin nëpër

rrjete? Sesi pengojmë çdo punë publike? Sesi nuk bashkohemi në një aksion pastrimi apo mbjellje pemësh? Si ka mundësi? Po të ishin gjallë pjesëmarrësit, nga Babë Myslimi dhe të tjerët, të majtë e të djathtë, nga Konferenca e Pezës, dhe të shikonin që ne kacafytemi për të penguar njëri-tjetrin, kjo nuk është normale. Ne nuk mund të pengojmë sot zhvillimin e Shqipërisë, të Tiranës, Pezës", tha Veliaj, teksa shtoi se kush është patriot i vërtetë, mbi të gjitha duhet të jetë një shqiptar që do progresin e më pas partinë.



Nostalgjikët e diktatorit Enver Hoxha në Pezë



## "Trima s'ka vetëm jugu dhe veriu"

Majko: Burra ka Shqipëria e Mesme, i kanë dalë zot vatanit

Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko deklaroi dje se burra trima s'ka vetëm në jug dhe veriu, por edhe Shqipëria e Mesme. "Kujtojmë ato ditë të veçanta 76 vjet më parë kur ekzistonin dy Shqipëri, njëra nën okupim dhe njëra këtu në Pezë, ku nisi shkëndija. Duhet t'i themi disa gjërat ashtu siç janë për historinë: Ata që thonë jo veriu, jo jugu, ta dinë se edhe në Shqipërinë e mesme ka pasur burra trima që i kanë dalë zot vatanit. Kjo është arsyeja pse mblidhemi sot të gjithë këtu, për të kujtuar dhe për t'i dhënë vendin që duhet asaj që është shkruar nga historia dhe nga aktet që i bëjnë nder këtij populli dhe këtij kombi", deklaroi z.Majko. Ai përmendi se: "Unë jam i majtë se të parët e mi kanë marrë pjesë në LANÇ. Kujtojmë ato ditë të veçanta 76 vjet më parë kur ekzistonin dy Shqipëri, njëra nën okupim dhe njëra këtu në Pezë".





Kryebashkiaku: Le të më heqin. PD: Çdo të ndodhte në Gjermani nëse i këndohej Hitlerit ?

# Peçi këngë për diktatorin Hoxha: O kapedan. PD: Të shkarkohet

## Shehu: Përbalti viktimat e komunizmit

Valentina Madani

**K**ryetari i Bashkisë Tepelenë, Tërmet Peçi, është shfaqur në një aktivitet duke kënduar këngë për diktatorin komunist Enver Hoxha. Mbrëmjen e së shunës, Peçi ka mbledhur në një darkë festive me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të qytetit, ku mori pjesë edhe këngëtarë Golik, i grupit polifonik të Bëncës. Goliku, kryebashkiaku i Tepelenës dhe dhjetëra të tjerë shfaqen në video duke i thurur lavde diktatorit Hoxha. Në një moment në video, Peçi shihet duke bërë shenjë me grusht të përshëndetjes së komunistëve. "Enver Hoxha kapedan legjendar, bëre Shqipërinë vigane," janë disa nga vargjet e këngës. Flamuj komunistë, foto të ish-diktatorit Enver Hoxha dhe shumë simbole të tjera janë përdorur në shumë raste në ceremoni zyrtare nga nostalgikë të Hoxhës. **SHKARKIMI**

Partia Demokratike i kërkoi dje kryeministrit Rama shkarkimin e menjëhershëm të kreut të bashkisë së Tepelenës Tërmet Peçi. Deputeti i qarkut Tritan Shehu i kërkoi edhe prokurorisë që të veprojë ndaj tij për shkelje ligji. Kryebashkiaku i Tepelenës, në një darkë zyrtare të shtruar nga Bashkia me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të saj, i ka thurur lavde dhe ka kënduar për diktatorin komunist Enver Hoxha. "I kërkoi kryeministrit, si deputet i qarkut, të shkarkojë menjëherë kryetarin e Bashkisë së Tepelenës, Tërmet Peçi. Gjithashtu, prokuroria duhet të veprojë ndaj tij për shkelje të ligjit. I bëj thirrje opinionit publik, mediave, shoqatave të ish-të përndjekurve politikë të reagojnë me forcë ndaj këtij skandali e turpi të vërtetë! Tërmeti i "bëmave të mëdha", mbrëmë në darkën zyrtare të shtruar nga Bashkia e Tepelenës me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të saj, i thur lavde e këndon për diktatorin Hoxha, gjë që më tej e publikon. Një sfidë e vërtetë kjo ndaj ligjit, demokracisë, një ofendim ky për proceset tona demokratike, një arrogancë e pa kufi ndaj ish-të persekutuarve, ndaj gjithë këtij populli, që e pagoi shumë shtrenjë atë diktaturë të egër. Një përbaltje kjo edhe e të gjithë atyre, që ranë apo luftuan fashizmin e nazizmin, për një Shqipëri të lirë, demokratike, të begatë, pavarësisht nga mënyra se si ata e perceptonin ketë në vitet



Kryetari i Bashkisë Tepelenë, Tërmet Peçi

**AKTIVITETI**

Tërmet Peçi shfaqet duke bërë shenjë me grusht të përshëndetjes së komunistëve. "Enver Hoxha kapedan legjendar, bëre Shqipërinë vigane." - janë disa nga vargjet e këngës

hej të ishte dje pjesë e festimeve dhe mos të merrej me këto histori. "Gjithçka ishte në kuadër të festimeve. Nuk kishte asgjë tjetër. Sa për reagimin e deputetit të PD-së, për këtë qark, Tritan Shehu, do e pyes pse nuk erdhi dje në aktivitet, po merret me këto histori? Po le të më heqin, ca të them unë. S'do merrem me këto histori", - tha kryebashkiaku Peçi. Në videon që po qarkullon gjërësisht në rrjetet sociale shihet se si Tërmet Peçi shoqëron me zë Golikun e famshëm të Bëncës, teksa këndojnë këngë për Hoxhën, madje ai në një moment përshëndet me grusht.

li sikur një Kryetar Bashkie t'i thurte lavde në një ceremoni zyrtare Hitlerit apo Musolinin? A mund të më përgjigjeni për këtë ju Z. Kryeministër?"; - shprehet deputeti i PD-së.

**REAGIMI**

Pas videos që po qarkullon në rrjetet sociale, ku shihet kryebashkiaku i Tepelenës Tërmet Peçi teksa këndon këngë kushtuar diktatorit En-

ver Hoxha, reagoi ky i fundit. Në një lidhje telefonike për 'BalkanWeb' Peçi pohoi se gjithçka ishte në kuadër të festimeve për rastin e 75-vjetorit të çlirimit të qytetit, në një darkë zyrtare të shtruar nga Bashkia e Tepelenës. Ndërkohë, pyetjes lidhur me kërkesën publike të Tritan Shehu për shkarkimin e kryebashkiakut, Peçi tha se deputeti i PD du-

### "Mungon ligji që të shkarkojë kryebashkiakun"

## Peçi këngë për Enver Hoxhën, ish -i përndjekuri: Jemi të shokuar!

**K**reu i Institutit të të Përndjekurve Politikë, Simon Miraka dënoi dje veprimin e kreut të Bashkisë së Tepelenës Tërmet Peçi, i cili shfaqej në një aktivitet duke kënduar këngë për Enver Hoxhën. I ftuar në News24, Simon Miraka tha se është i shokuar nga veprimet e kreut të bashkisë së Tepelenës dhe fyerje për ish të përndjekurit. "Të them të drejtën jam shokuar, sepse nuk pritet që mbas 28 vitesh demokraci t'i këndohet diktatorit, kur dihet se çfarë ka bërë ai. Është një fyerje jo vetëm për ish të përndjekurit, por për të gjithë. T'i këndosh dikta-



torit tregon se ne nuk kemi ndërgjegje. Ne kemi sadisfaksion kur shohim një palë që vuan. Por përderisa nuk kemi një ligj që të ndalojë simbolet e komunizmit ligjërisht nuk ke si e donon. Ndërgjegjja nuk e ekziston dhe nuk mund t'i thuash gjë atij që këndon këngët e Enverit"- tha

z.Miraka. Kreu i Institutit të të Përndjekurve Politikë komentoi edhe deklaratën e deputetit të PD, Tritan Shehu që i kërkoi kryeministrit Edi Rama shkarkimin e kreut të bashkisë së Tepelenës. "Shkarkimi bëhet kur shkelet ligji. Nëse ka një ligj që ndalon simbolet komuniste atëherë ai shkarkohet me ligj. Mesa di unë një ligj të tillë nuk ka, por di që PD po përgatitet për një ligj të tillë. Thirrja e Tritan Shehut duhet të bazohet në ligj dhe jo në dëshira. Unë thashë që është një fyerje veprimi i Tërmet Peçit dhe presim një reagim nga ai"- theksoi z.Miraka.



**Mesazhi**

**RAMA: Z.NANO, JETOFSH E GËZOFSH**  
Nën kryetari i LSI Luan Rama i dedikoi dje një postim në 'Facebook' Fatos Nanos, në ditën e tij të lindjes. Në vend të kartolinës, ai ka zgjedhur një foto të 18 viteve më parë, nga koha kur Nano drejtoi PS-në. "Gëzuar ditëlindjen Fatos Nano! Jetofsh gjatë e gëzofsh sa të jetosh! Dhe në vend të kartolinës, këtë foto të 16 shtatorit të vitit 2000, si kujtim nga ajo kohë kur drejtonim PS, dhe kur ditëlindjen tënde nisim ta festojm gjithnjë nga Pezën lavdimadhe e historisë së antifashizmit..." - shkruan Rama.

### Nisma e PD, ligj për ndalimin e simboleve të komunizmit

**P**D ka finalizuar projektligjin që ndalon simbolet komuniste. Grupi i punës pas asistencës së CDU-së gjermane tashmë kanë gati draftin që ndalon me ligj simbolet e diktaturës dhe portretet e ish-udhëheqësve të saj. Dokumenti i demokratëve në një nga pikat thelbësore të saj ka ndalimin me ligj të Partisë Komuniste të Shqipërisë, ndërkohë që për herë të parë kërkohet që "sapo ligji të hyjë në fuqi, bashkitë me propozimin e Institutit për Studimin e Krimave të Komunizmit duhet të ndryshojnë emrat e rrugëve, shesheve, qyteteve, që mbajnë emrat ish-udhëheqësve të diktaturës. Gjithashtu, projektligji parashikon që nëse do të ketë manifestime të propagandës komuniste të përdoret si shembull në mirë rastin i Italisë me dënimin me 1 vit e 8 muaj për simbolet fashiste. Po ashtu demokratët kërkojnë me ligj që të shfuqizohen dekoratat, titujt që janë marrë gjatë kohës së diktaturës.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

PASURIA NR. 2/69+2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ILMU SULA.

ÇMIMI **6.800.000 LEKË**. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 01.10.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

# SITUATA POLITIKE REAGIMET

Presidenti, Kosova dhe Serbia të konsolidojnë marrëdhëniet pa prekur kufijtë

## Integrimi, Meta: BE të shohë progresin e bërë nga Shqipëria

### "Reforma në drejtësi, si goditje ndaj krimit"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjatë një interviste për gazetën prestigjioze italiane "Il Messaggero", shpreh se është e rëndësishme që Kosova dhe Serbia të konsolidojnë marrëdhëniet e tyre drejt integrimit evropian, por pa prekur çështjen e kufijve. I pyetur për çështjen emigrantëve, Meta tha se Italia nuk duhet lënë e vetëm në përballimin e këtij fenomeni. Teksa flet për integrimin, kreu i shtetit nënvizon se BE duhet të shohë në optikën e duhur progresin e bërë nga Shqipëria.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

#### ANËTARËSIMI

"Shpresojmë që bisedimet të hapen dhe Shqipëria të ketë anëtarësim të shpejtë. Dëshiroj që BE të shohë në optikën e duhur progresin e bërë nga Shqipëria, jo vetëm për integrimin evropian, por edhe për të forcuar ekonominë dhe shtetin e së drejtës", tha Presidenti Meta.

#### KRIMI

"Puna e mirë e prokurorisë Antimafia të Italisë dhe bashkëpunimi i shkëlqyer i shërbimeve tona sekrete ka qenë dhe është kryesore në luftën kundër klanëve kriminale. Një rëndësi të veçantë në këtë drejtim ka edhe reforma në drejtësi të cilën po implementojmë", - theksoi z.Meta.

#### Brukseli u tregua i ftohtë ndaj ndërhyrjes tuaj në ndihmë të Italisë.

Nuk dua të bëj polemika apo interpretime, të cilat nuk shërbejnë. Unë di që në fund të gjithë kanë kuptuar gjestin tonë si një veprim solidariteti dhe vullneti të mirë. Megjithatë mendoj se Italia nuk duhet lënë e vetme përballë fenomenit. Ne i detyrohemi Italisë për ndihmën dhe solidaritetin e dhënë ndaj shqiptarëve në vitet '90. Mendoj se të gjithë i detyrohen Italisë, duke kuptuar vështrësisht dhe sakrificat e bëra përballë fenomenit të migracionit me një mikpritje të rrallë. **Shpejt do të duhet të hapni bisedimet për anëtarësim në BE?**

Shpresojmë që bisedimet të hapen dhe Shqipëria të ketë anëtarësim të shpejtë. Dëshiroj që BE të shohë në optikën e duhur progresin e bërë nga Shqipëria, jo vetëm për integrimin evropian, por edhe për të forcuar ekonominë dhe shtetin e së drejtës.

#### Keni frikë për destabilizim

Shpresojmë që bisedimet të hapen dhe Shqipëria të ketë anëtarësim të shpejtë. Dëshiroj që BE të shohë në optikën e duhur progresin e bërë nga Shqipëria, jo vetëm për integrimin evropian, por edhe për të forcuar ekonominë dhe shtetin e së drejtës.

#### pas tensioneve të fundit mes Kosovës dhe Serbisë?

Për paqen, jo vetëm në rajonin tonë, është themeltare që Beogradi dhe Prishtina të konsolidojnë marrëdhëniet dhe të shikojnë bashkë, akoma më shumë, në rrugën e integrimit evropian, por pa prekur çështjen e kufijve. **Çfarë prisi nëse nga vizita që do të bëni te Papa?** Ne falënderojmë Atin e Shenjtë për vëmendjen e veçantë që ka pasur për Shqipërinë dhe mbështetjen për bashkëjetesën tonë shembullore fetare. Mbi të gjitha vendi ynë është vendi i Shën-Jtores Nënë Terezë dhe i Kardinalit Ernest Simoni-Troshani, i martirizuar për dekadë në burgjet komuniste bashkë me dhjetëra klerikë të tjerë.

#### Italia është partneri i parë tregtar i Shqipërisë...

Gjysma e eksporteve shqiptare shkon drejt Italisë. Turizmi është rritur dhe gjithashtu prezenca e operatorëve italianë në këtë sektor.

Tani na duhen më shumë përkrahje dhe iniciativa për të rritur bashkëpunimin dhe mirënjohjen e popujve tanë. Duhet, gjithashtu, më shumë bashkëpunim për sa i përket modernizimit të infrastrukturave.

#### Kryeprokurori i Antimafias italiane, Federico Cafiero del Raho, ka ngritur shqetësimin se grupet kriminale shqiptare janë po aq të forta sa klanet mafioze italiane...

Pak kohë më parë ministrat tanë të Drejtësisë, Alfonso Bonafede dhe Etilda Gjonaj u takuan për të rritur bashkëpunimin në këtë drejtim. Puna e mirë e prokurorisë Antimafia të Italisë dhe bashkëpunimi i shkëlqyer i shërbimeve tona sekrete ka qenë dhe është kryesore në luftën kundër klanëve kriminale. Një rëndësi të veçantë në këtë drejtim ka edhe reforma në drejtësi të cilën po implementojmë.

#### C' mendim keni për dyshimet e qeverisë italiane për sa i përket ndërtimit të gazsjellësit TAP, që kalon nëpër territorin tuaj?

TAP nuk është i rëndësishëm vetëm për Shqipërinë dhe Italinë, por për sigurinë energjetike të mbarë Europës. Autoritetet italiane do t'i duhej të merrnin veprime të menjëhershme për sa i përket kësaj çështje.



### Ndryshimi i kufijve

## Mediu: Krijimi i Ushtrisë së Kosovës, me rëndësi në konsolidimin e shtetit

Kreu i republikanëve Fatmir Mediu ka bindjen e plotë se krijimi i Ushtrisë së Kosovës, hap i rëndësishëm në konsolidimin e shtetit. "Dialogu me Serbinë duhet të finalizojë njohjen e Pavarësisë së Kosovës dhe garantimin e integritetit territorial dhe kufijve të Kosovës", kështu shpreh Fatmir Mediu, në një takim zyrtar që pati me Ramush Haradinajn. Ai deklaroi se ndërtimi i një shteti demokratik dhe funksional, është parakusht për të ardhmen e saj në partneritetin me SHBA dhe BE, duke shmangur çdo lloj ndërhyrje nga vende të tjera, të cilat janë kundër të ardhmes euroatlantike të Kosovës. "Vizita në fund të shtatorit në SHBA, New York dhe Washington DC e kryeministrit Haradinaj, do t'i shërbejë këtij qëllimi dhe forcimit të marrëdhënieve me SHBA. Ndërtimi i Ushtrisë së Kosovës, si një forcë e armatosur që e ka të ardhmen në NATO, është një hap i rëndësishëm në konsolidimin e shtetit të pavarur të Kosovës", theksoi kreu i PR-së Fatmir Mediu.

#### DIALOGU

"Dialogu me Serbinë duhet të finalizojë njohjen e Pavarësisë së Kosovës dhe garantimin e integritetit territorial dhe kufijve të Kosovës", -tha z.Mediu.

SHPALLJE ANKANDI  
Date 18.09.2018, Ora 16:00  
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyrë 107, Tiranë. Tel. 404506426. Cel. 067 201 9460/068 904 9202. e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.  
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e pajalishme të dorëzuesive Petrit Sani Sina dhe Majlinda Xhavit Sina:  
"Apartament" me sipërfaqe 54 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 112/6-1-7, zona kadastrale 2932, vol. 14, faqe 26, adresa: Lajga "Gjokë Doc", Peshkopi, Dibër.  
Cmimi fillëstar i ankandit të dytë është në shumën 1 120 000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) lekë.  
Ankandit do të zhvillohet në ambientin e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyrë 107, Tiranë.

SHPALLJE ANKANDI  
Date 21.09.2018, Ora 16:00  
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyrë 107, Tiranë. Tel. 404506426. Cel. 067 201 9460/068 904 9202. e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.  
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e pajalishme të dorëzuesive Petrit Sani Sina dhe Majlinda Xhavit Sina:  
"Apartament" me sipërfaqe 54 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 112/6-1-7, zona kadastrale 2932, vol. 14, faqe 26, adresa: Lajga "Gjokë Doc", Peshkopi, Dibër.  
Cmimi fillëstar i ankandit të dytë është në shumën 1 120 000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) lekë.  
Ankandit do të zhvillohet në ambientin e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyrë 107, Tiranë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
Zyra përmbarimore "Besit 2018"  
SHPALLJE ANKANDI  
Më datë 16 tetor 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shitjen e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq 1, ZK.8603, me cmim fillëstar 3307500 lek; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, me cmim fillëstar 25156600 lek  
Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN" shpk (NUIJ 397201218L).  
Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644





Idrizi flet për 3 deputetët: Rastësisht në listë, nuk dinë as selinë e partisë

# PD-PDIU bashkë kundër Ramës, Basha: Fund qeverisë së krimit

"Kam dakordësinë e aleatëve, përfshi dhe Dulen"

Valentina Madani

Lulzim Basha dhe Shpëtim Idrizi tash më kanë zyrtarisht një marrëveshje konkrete për bashkëpunim në opozitë kundër qeverisë "Rama". Dëshmitar i marrëveshjes së PDIU-së me Partinë Demokratike, në opozitë dje u bë ish-Presidenti i Asamblesë Parlamentare të OSBE, Riccardo Migliori. Pas një ore takim të zhvilluar mes dy kryetarëve dhe drejtuesve të tjerë partiakë, palët njoftuan se PDIU-ja, e cila në themel të programit të saj ka çështjen çame, do të rreshtohet në frontin opozitar. Basha, dha garanci se do vendim është marrë nën konsultim me aleatë, duke lënë të kuptohet se për pranimin në gjirin e opozitës të Shpëtim Idrizit ka pasur dhe mirëkuptimin e Vangjel Dules. "Bashkëpunimi ynë do të shtrihet në të gjitha fushat me atë më emergjent të shkëputjes së lidhjeve të krimit me politikën, të organizimit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme dhe të ofrimit të një zgjidhje politike, të cilinim të drejtësisë nga kapja politike dhe të cilinim të ekonomisë nga oligarkia dhe monopoli për t'u rikthyer shqiptarëve jo vetëm e thjeshtë paratë e vjedhura nga bashkëpunimi midis oligarkëve të korruptuar dhe qeveritarëve, por edhe shpërsend dhe mundësinë e zhvillimit ekonomik dhe punësimin të rinjë dhe gjithë qytetarëve shqiptarë", tha z.Basha. Ai përmendi se PD ka qenë, është dhe mbetet thellësisht e angazhuar për të drejtat e shqiptarëve të Çamërisë në dimensionin historik të kujtesës, respektit dhe nderimit për viktimat, në dimensionin e sigurimit të lëvizjes së lirë për qytetarët shqiptarë të lindur në Çamëri dhe në dimensionin e përpjekjeve juridike dhe diplomatike për të garantuar të drejtën e pronës për të gjithë qytetarët shqiptarë të Çamërisë". Lidhur me dakordësinë apo jo të kreu të PBDNJ, Basha tha: "Kjo që u thashë është qëndrimi që unë kam ndarë dhe kënaqësinë të bashkëndaj me të gjithë drejtuesit duke përfshirë këtu edhe kryetarin e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut". Më tej



Lulzim Basha dhe Shpëtim Idrizi dje gjatë nënshkrimit të marrëveshjes PD-PDIU

**NARD NDOKA**  
Kreu i PDK-së, Nard Ndoqa, e sheh pozitivisht afrimin e partive të reja në frontin opozitar. "Është normal afrimi i partive të reja. Ka ardhur momenti i zgjerimit të harkut opozitar edhe me forca politike, shoqata, grupe interesi dhe individë. Unë do vijoj të jem pjesë e opozitës", tha kreu i PDK-së.

kreu i PD garantoi: "Opozita është në frontin më të gjerë dhe më e angazhuar dhe e fortë me bashkimin e të gjithë faktorëve kryesorë politikë të vendit pas konkludimit me sukses të bisedimeve me PDIU për të shërbyer në interesin e qytetarëve në këtë moment kritik për Shqipërinë dhe shqiptarët. PD dhe opozita e bashkuar kanë sot një mision jetik për çdo familje shqiptare. T'i japim fund bashkëqeverisjes me krimin, të largojmë një orë e më parë aleancën e pushtetit me krimin që ka zaptuar Qeverinë, Parlamentin, institucionin e drejtësisë, policinë, të cilinimë vendin nga sundimi i bandave". Edhe z.Idrizi foli për bashkimin e opozitës kundër qeverisë. "Ne kemi nevojë për një opozitë të fortë, e cila të mos jetë thjesht reflektive karshi pushtetit, kemi nevojë për një opozitë të fortë që të ketë alternativën e saj për të dalë nga ky tranzicion i tejzgjuar për t'u dhënë shpresë shqiptarëve", theksoi kreu i PDIU-së. Shpëtim Idrizi, nuk është pjesë e parlamentit, por nën siglën e partisë së tij sot në Kuvend janë 3 deputetë, të cilët me votë mbështesin PS. I pyetur për këta deputetë, Idrizi tha se ata ndodheshin rastësisht në listën e kësaj partie, megjithëse në jo pak raste janë përzgjedhur për shkak se janë të "fortë" në zonat elektorale ku kanë fituar. Tre deputetët që kanë braktisur PDIU-në, janë Reme Lala, Elena Xhika dhe Dritan Bici. "Për pyetjen që më bëtë, jeni një vit me vonesë, sepse këta deputetë të komititit të shqiptarëve të Çamërisë. Janë ndodhur rastësisht nëpër

listat tona. Në qoftë se do të zgjatet këtu, ju e dini se janë "ekzekutuar" mandati i Tiranës, i Fierit dhe i Elbasanit, sepse ata dolën në siglën e PDIU dhe që prej

ditës së parë votuan mazhorancën. Po të pyesësh sot, ata nuk e dinë ku ndodhet selia e Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet", deklaroi z.Idrizi.

## BASHA:PADRINOT E BIXHOZIT

Kreu i PD, Basha postoi dje në 'Facebook', një video në të cilën, sipas tij, tregohet se pse industria e bixhozit u shumëfishua gjatë qeverisë 'Rama'. Basha shprehet se mbështetja e qeverisë ndaj bixhozit katërfishoi pikat e basteve nga 920 në 4200. "Operacioni 'Fund i marrëzisë' nuk i mbylli lojërat e fatit, por ky biznes u rrit me 4 herë. "Rama dhe Xhafaj janë padrinot e bixhozit në Shqipëri".

## Migliori: PD, jo fortesë e mbyllur, por një shesh i hapur

L pranishëm në zyrtarizimin e marrëveshjes mes PD-së dhe PDIU-së dje ishte dhe ish-Presidenti i Asamblesë Parlamentare të OSBE, Riccardo Migliori. Ai u bë dje dëshmitarë i marrëveshjes së PDIU-së me Partinë Demokratike, në opozitë. "Jam këtu si Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut dhe si mik i shqiptarëve. Jam këtu, sepse është një ditë e bukur për të gjithë shqiptarët, sepse kjo marrëveshje është një marrëveshje e dobishme, pasi thjeshton politikën shqiptare, rrjedhimisht është e dobishme për demokracinë shqiptare. Është një pakt patriotik, sepse është i shtyrë vetëm nga qëllimet fisnike për t'u ardhur në ndihmë shqiptarëve. Është e rëndësishme pasi është kryesisht një pakt për opozitën, që në këtë moment nuk dëshiron të jetë një fortesë e mbyllur, por një shesh i hapur për çdo kontribut të çdo shqiptari vullnetmirë, në mënyrë që të ndihmojë në kapërcimin e këtij momenti të vështirë për këtë vend të rëndësishëm të Europës e të Ballkanit. Ja pse unë jam sot këtu e ja pse në Tiranë sot është një ditë me diell", theksoi ish-Presidenti i Asamblesë Parlamentare të OSBE, Riccardo Migliori.



## ZBARDHET MARRËVESHJA BASHA-IDRIZI, QEVERISJE PA KRIMIN DHE ME ZGJIDHJE TË ÇËSHTJES ÇAME

Partia Demokratike dhe Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet angazhohen së bashku për një qeverisje të ciluar nga krimi. Në marrëveshjen prej 6 pikash të firmosur mes dy kryetarëve të partive, Lulzim Basha dhe Shpëtim Idrizi, mbizotëron vullneti për të larguar qeverinë që bashkëpunon me krimin, për të krijuar kushtet për zgjedhje të lira e të ndershme dhe më pas për qeverisje në interes të qytetarëve. Një pikë e rëndësishme është dhe angazhimi i dy partive për zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve të Çamërisë në të gjitha dimensionet e saj. Me afrimin e PDIU-së në Frontin e Përbashkët Opozitar, ku bëjnë pjesë të gjitha partitë e tjera parlamentare LSI, PR, PBDNJ, PDK, PAA, Lulzim Basha ia ka dalë të realizojë bashkimin më të madh politik sot në Shqipëri. 6 PIKAT E MEMORANDUMIT PD-PDIU  
-Rikthimin e normalitetit politik e institucional në vend, duke krijuar kushtet për ndarjen e politikës nga krimi, që po rrenon çdo standard demokracie në vend.  
-Krijimin e kushteve për zgjedhje të lira, të drejta e të ndershme, ku qeveria të dalë nga vota e lirë e shqiptarëve dhe jo nga skemat mafioze dhe lidhja me krimin, që ka deformuar vullnetin e shqiptarëve.  
-PD dhe PDIU angazhohen për zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore me qëllim rikthimin urgjent të normalitetit në vend dhe ndarjen e sistemit politik nga fenomeni i blerjes së votës dhe manipulimit të saj.  
-PD dhe PDIU angazhohen për zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve të Çamërisë në të gjitha dimensionet e saj.  
-PD dhe PDIU angazhohen për fuqizimin e ekonomisë, duke siguruar lirinë e sipërmarrjes, konkurrencës dhe mundësinë për të gjithë.  
-PD dhe PDIU angazhohen për një mirëqeverisje sa më pranë qytetarëve, të përkushtuar për zgjidhjen e problemit të papunësisë, për rritjen ekonomike, luftën pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.  
-Me afrimin e PDIU-së në Frontin e Përbashkët Opozitar, ku bëjnë pjesë të gjitha partitë e tjera parlamentare LSI, PR, PBDNJ, PDK, PAA, Lulzim Basha ia ka dalë të realizojë bashkimin më të madh politik sot në Shqipëri.

Operacioni "Piramida", bien në pranga Alment Bakullati dhe Klement Domeri

## SARANDE

Dy persona janë arrestuar në flakë në kufi me Greqinë me 33.4 kg kanabis Sattiva. Konkretisht shtetasit Alment Bakullati, 27 vjeç, dhe Klement Domeri, 35 vjeç, të dy banues në fshatin Shalë, u kapën në Qafën e Hanit në Sarandë, në kuadër të operacionit antidrogë të koduar "Piramida". Mësohet se operacioni ka nisur dy ditë më parë rreth orës 10:00 të paradites, pas një informacioni të siguruar në rrugë operative nga Drejtuesi të Komisarariatit të Sarandës. Ndryshe nga herët e tjera këtë radhë tentativa për trafikun e drogës është bërë gjatë orëve të para të paradites. Lënda narkotike të cilën shtetasit e mësipërm po e transportonin drejt shtetit grek, u gjet e ndarë në 6 pako. Po ashtu mësohet se njëri prej të arrestuarve, 35-vjeçari Klement Domeri është emër i njohur për policisë pasi ka qenë më parë i arrestuar në Kakavijë me 5 kg marijuanë të fshehur në makinë.

## OPERACIONI

Finalizohet operacioni antidrogë i koduar "Piramida" dhe sekuestrohen 33.4 kg lëndë narkotike e dyshuar si Cannabis Sattiva. Seksioni për Krimet, Krimi i Organizuar dhe Krimet e Rënda Sarandë në bashkëpunim me Kufirin dhe Migracionin Sarandë dhe Policinë Greke, kanë bërë të mundur realizimin e këtij operacioni antidrogë, mbi bazën e të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit: Alment Bakullati, 27 vjeç, banues në fshatin Shalë, Konispol dhe Klement Domeri, 35 vjeç, banues në fshatin Shalë, Konispol. "Shërbimet e mësipërme bënë të mundur kapjen e tyre pasi më datë 15.09.2018, këtyre shtetasve në bashkëpunim me

# Transportonin drogë drejt Greqisë, arrestohen dy persona në Sarandë

## Sekuestrohen 6 pako me 33.4 kg kanabis



### Droga u gjet e ndarë në 30 pako

### Tentoi të trafikonte 41 kg marijuanë që vinte nga Shqipëria, arrestohet greku

Një sasi drogë është sekuestruar ditën e djeshme nga policia greke pasi një aksioni të zhvilluar për ndalimin e një automjeti që vinte nga kufiri gjelbër me Shqipërinë. Automjeti u ndalua nga policia e Janinës në orët e para të mëngjesit në rrugën Egnatia, në Tiria. Gjatë kontrollit të ushtruar brenda në mjet janë gjetur dhe sekuestruar 3 çanta me 41 kg 600 gram mari-



juanë e ndarë në 30 pako. Në pranga ra drejtuesi i mjetit, një 31-vjeçar grek, identiteti i të cilit nuk dihet. Prej fillimit të vitit e deri sot, në Igumenicë, Korfuz, Lefkadhja, Kefalonia, Janinë, Athinë, Selanik, Artë, Aitiloakarnania, Kostur, Grevena, Follorinë, Aleksandroupoli, etj, policia greke ka sekuestruar rreth 8.2 tonë marijuanë që vinte nga Shqipëria.

# 33.4

### KG KANABIS

Finalizohet operacioni antidrogë i koduar "Piramida" dhe sekuestrohen 33.4 kg lëndë narkotike e dyshuar si Cannabis Sattiva. Lënda narkotike u gjet e ndarë në 6 pako, të cilën dy të ndaluarit po e transportonin nga kufiri i gjelbër drejt shtetit grek.



### Morën peng 25-vjeçarin në Elbasan, arrestohen 3 persona

**ELBASAN.** Policia e Elbasanit ka vënë në pranga tre persona, të cilët akuzohen se kanë marrë peng një të ri dhe e kanë kërcënuar. Ngjarja në fjalë është regjistruar në lagjen "Emin Matraxhiu". Burime zyrtare thanë se pas hekurave përfunduan Arben Raxha, 48 vjeç, Bekim Raxha, 21 vjeç, Erion Kaçuli, 18 vjeç, të tre banues në fshatin Griqan.

Ata akuzohen se kanë marrë me forcë në makinë e tyre dhe e kishin kërcënuar shtetasin me inicialet A.S, 25 vjeç, banues në Elbasan. Po ashtu burimet thanë se gjithçka ka nisur për motive të dobëta, ndërsa të arrestuarit do të akuzohen për veprën penale "Hegjja e paligjshme e lirisë", parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal.

### Policia sekuestron kamerat e sigurisë

### Pogradec, vendoset tritol në banesën e biznesmenit Bajram Fejzollari

**POGRADEC.** Një shpërthim tritolit ka ndodhur gjatë natës së djeshme pranë banesës së një biznesmeni në qytetin e Pogradecit. Policia bën me dije se rasti në fjalë ndodhi në orën 00:45 në lagjen nr.1 të qytetit. Mësohet se shënjestër e sulmit ka qenë banesa e biznesmenit Bajram Fejzollari 60 vjeç. Sipas informacioneve paraprake, sasia e eksplozivit shpërtheu në lulishten e banesës së 60-vjeçarit, konkretisht rreth 25 metra larg mureve të banesës. Fatmirësisht nga shpërthimi nuk ka të lënduar dhe as dëme materiale. "Më datë



16.09.2018, rreth orës 00:45, në lagjen nr. 1 në Pogradec, në lulishten e banesës së shtetasit B.F, 60 vjeç, ka shpërthyer një sasi e vogël lëndë shpërthyes. Nga shpërthimi, nuk ka as dëme në njerëz dhe as dëme mate-

riale. Po punohet për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorëve", thuhet në njoftimin e policisë. Ekspertë të lëndëve eksplozive nga Tirana i janë bashkuar grupit hetimor

që po punon për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, por deri tani policia nuk ka dhënë detaje, të mekanizmit që është përdorur për të aktivizuar sasinë e tritolit dhe më pas realizuar shpërthimin e tij. Ndërkohë biznesmeni Fejzollari gjatë dëshmisë së dhënë në polici ka mohuar të ketë konflikte me persona të tjerë. Policia mësohet të ketë sekuestruar pamjet e kamerave të sigurisë në zonë, nga ku besohet që do të zbardhet ngjarja.

### Gjurmë gjaku në vendngjarje

### Digjet klinika dentare në Tiranë, dyshohet e qëllimshme

**TIRANE.** Një klinikë dentare është djegur gjatë natës së djeshme në Laprakë. Mësohet se klinika që është djegur i përket stomatologut Besian Tusha. Policia dyshon se zjarrvënja ka qenë e qëllimshme, pasi në vendin e ngjarjes janë gjetur gjurmë gjaku. Dyshohet se autori ende i paidentifikuar është lënduar kur ka thyer xhamin e derës së klinikës nga ku edhe është vënë zjarri. Si pasojë e zjarri ka pasur dëme të konsiderueshme materiale, ndërsa nuk ka pasur të lënduar. Policia ka shoqëruar një person të dyshuar. Vëlojnë hetimet për zbardhjen e plotë të shkaqeve dhe motiveve të ngjarjes.





Aksioni i RENEA dhe FNSH, të ndaluarit nën akuzë për armëmbajtje pa leje dhe pastrim parash

Ina Allkanjari

KRUJE

Gjykata e Krujës ka zhvilluar ditën e djeshme seancën gjyqësore për dhënien e masës së sigurisë për pesë të arrestuarit gjatë aksionit të policisë në Nikël. Seanca është zhvilluar nën masë të rrepta sigurie. Gjykata e Krujës ka qenë e rrethuar nga forca të shumta të policisë lokale dhe repartit të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë.

Gjyqtarja Enkelejda Hoxha ka vlerësuar të ligjëshëm arrestimin pas relativitetit të prokurorit të çështjes Petrit Cano, duke lënë masën "arrest me burg" për Ylli Çanun, Valter Bamin, Skënder Lezen, e Marklen Haka. Pavarësisht kërkesës së prokurorisë gjykata vendosi masën e sigurisë "arrest shtëpie" për Lutfi Hakën. Të ndaluarit akuzohen për armëmbajtje pa leje dhe pastrim parash. Për prokurorinë, paratë dyshohet se janë produkt i aktiviteteve kriminale, kryesisht gjobëvënies. Nga aksioni i pak ditëve më parë nga forcat RENEA u arrestuan pesë persona, konkretisht Lutfi Haka 67 vjeç, Marklen Haka 27 vjeç, Ylli Çangu, 42 vjeç, Skënder Leza, 34 vjeç, Valter Bami, 32 vjeç. Në banesat e tyre policia gjeti dhe sekuestroi armë dhe para. Aksioni i policisë në Nikël të Fushë-Krujës nisi rreth orës 05:00 të mëngjesit të 12 shtatorit dhe pati si qëllim goditjen dhe pati si qëllim goditjen e një prej grupeve më të përfolur për disa ngjarje të rënda në Tiranë.

AKSIONI I POLICISË

Pas një hetimi intensiv disa mujor mbi veprimtarinë e grupeve kriminale në Nikël të Krujës, zhvilluar në këto hetime në kuadër të operacionit "Forca e ligjit", si dhe në funksion të hetimeve të ngjarjeve të fundit kriminale në ndodhura, Policia e



AKUZA

Aksioni i policisë në Nikël të Fushë-Krujës nisi rreth orës 05:00 të mëngjesit të 12 shtatorit dhe pati si qëllim goditjen e një prej grupeve më të përfolur për disa ngjarje të rënda në Tiranë. Në banesat e tyre policia gjeti dhe sekuestroi armë dhe para. Të ndaluarit akuzohen për "Mbajtja pa leje të armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve të ftohta" dhe "Pastrimi i Produkteve të veprës penale".

Shtetit, përkatësisht Drejtoria Vendore e Policisë, Departamenti i Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme, Forcat speciale RENEA, FNSH, trupat e posaçme operacionale në bashkëpunim me Prokurorinë, kanë arritur të ndalojnë në Nikël të Krujës

disa elementë me rrezikshmëri shoqërore të lartë, anëtarë të grupeve kriminale aktive në këtë territor, por edhe më gjerë. "Veprimtaria hetimore disa mujore e Policisë së Shtetit e zhvilluar në këtë kuadër ka konsistuar në përgjimin, ndjekjen dhe gjur-

minin e këtyre elementeve kriminale si dhe mbledhjen e të dhënave në rrugë operative me qëllim evidentimin sa më të plotë dhe sa më të qartë të veprimtarisë kriminale të personave të dyshuar për kryerjen e kësaj veprimtarie. Bazuar në urdhra kontrolli të

# Gjykata e Krujës lë në burg katër të 'fortët' e Niklës

67-vjeçari Lutfi Haka lihet në "arrest shtëpie"

MASA E SIGURISË

Arrest me burg

◆ Marklen Haka 27 vjeç, banues në fshatin Zezë, Krujë, i dënua më parë

◆ Ylli Çangu, 42 vjeç, banues në fshatin Nikel, Krujë, i dënua më parë

◆ Skënder Leza, 34 vjeç, banues në fshatin Larushk, Krujë

◆ Valter Bami, 32 vjeç, banues në Larushk, Krujë

Arrest shtëpie

◆ Lutfi Haka 67 vjeç, banues në fshatin Zezë, Krujë, i dënua më parë

miratuar me vendim të Gjykatës, Policia e Shtetit ushtroi kontrollin në banesat të përdorura prej personave të dyshuar si anëtarë të grupeve kriminale. Operacioni nisi rreth orës 05:30 të mëngjesit të datës 12 shtator", thuhet në njoftimin e policisë. Gjatë këtij operacioni u shoqëruan një numër personash dhe u arrestuan 5 shtetas. Ata janë: Lutfi Haka 67 vjeç, banues në fshatin Zezë, Krujë, i dënua më parë; Marklen Haka 27 vjeç, banues në fshatin Zezë, Krujë, i dënua më parë; Ylli Çangu, 42 vjeç, banues në fshatin Nikel, Krujë, i dënua më parë; Skënder Leza, 34 vjeç, banues në fshatin Larushk, Krujë; Valter Bami, 32 vjeç, banues në Larushk, Krujë. Gjithashtu janë sekuestruar armë, mu-

niciro, mjet të blinduar, euro, dollarë e lekë si dhe sende të tjera të poseduara në mënyrë të paligjshme. Konkretisht janë sekuestruar: 2 armë zjarri pistolette; 4 armë gjahu e pushke sportive; 5 armë të ftohta; sasi fishekësh; 4 palë dylybi; 1 radio transmetuese; 39 000 euro; 1 200 dollarë amerikanë; 2 900 000 lekë të reja; 8 aparate celulare; 1 automjet i blinduar etj. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për veprimet të mëtejshme për veprat penale "Mbajtja pa leje të armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve të ftohta" dhe "Pastrimi i Produkteve të veprës penale".

39-vjeçari rezulton i dënua më parë për mashtrim

## Lëvizte i armatosur, arrestohet lushnjari Xheni Xhumari

LUSHNJE- Një 39-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Lushnjës, ditën e djeshme pasi lëvizte me armë zjarri pa leje. Bëhet fjalë për shtetasin Xheni Xhumari, banues në Lushnje. Sipas policisë, arrestimi i këtij shtetasi u bë pasi në lagjen "Karbunarë e Madhe" Lushnje, gjatë kontrollit të ushtruar në mjedin tip "Benz", brenda në çantën e tij të dorës u gjetën dhe sekuestrua në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë pa



leje, 1 krëhër, 14 fishekë pistolette dhe 4 fishekë arme gjahu. Materialet hetimore iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për veprat penale "Mbajtja pa leje e

armëve luftarake dhe municionit", dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive" parashikuar nga Nenet 278/a dhe 280 të Kodit Penal. Gjithashtu, mësohet se 39-vjeçari ka qenë proceduar me parë për plagosje të lehte dhe për mashtrim, pasi kishte marrë karburant nga paguar si dhe ka rreth një javë që ka ardhur nga jashtë shtetit. Mësohet se ai ka qenë në burg dhe jashtë Shqipërisë.

Makthi i qytetarëve zbardhen grabitjet e 'skifterëve'

## Autor të katër vjedhjeve, arrestohen dy minore në Vlorë

VLORE- Dy të mitur kanë rënë në prangat e policisë së Vlorës, pasi akuzohen se janë autorë të 4 vjedhjeve të dokumentuara. Policia bën me dije se dy të miturit kanë vjedhur në banesa, dyqane dhe rrugë. Seksioni për Krimet pranë Komisarariatit të Policisë Vlorë, ka bërë të mundur kapjen dhe arrestimin e shtetasve: A.Z., 17 vjeç, banues në Vlorë; F.B., 16 vjeç, banues në Vlorë. Sipas policisë, arrestimi i tyre u bë pasi më datë 15 shtator 2018, në lagjen "24 Maji" këta



shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë vjedhur me thyerje dyqanin në pronësi të shtetasit A.K. në të cilin kanë marrë kasën fiskale me disa para. Nga hetimet e kryera, ka rezultuar se këta shtetas

dyshohet se janë autorë të 4 vjedhjeve të tjera regjistruar si më poshtë: më datë 08.05.2018 - vjedhje banese; më datë 27.06.2018 - vjedhje banese; më datë 06.08.2018 - vjedhje dyqani; më datë 09.08.2018 - vjedhje në rrugë. Vjedhje për të cilat po punohet për dokumentimin e plotë të tyre. Materialet u referuan në prokurori për veprat penale "Vjedhja" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 25 të Kodit Penal.

Kryebashkiaku: Ftoj nxënësit që të mirëmbajnë mjediset e reja. Librat falas, nismë e arrirë

Voltiza Duro

# Dita e parë e shkollës, 'Isa Boletini' me 17 klasa të reja

*Veliaj: Investimet po vazhdojnë në qendër e periferi*

Këtë vit të ri shkollor, nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Isa Boletini" do ta zhvillojnë mësimin vetëm me një turn dhe jo me dy, si më parë. Falë investimit të Bashkisë së Tiranës, shkolla në Kodër-Kamzë do të ketë 17 klasa të reja, çka shmang përfundimisht mësimin me dy turne. Kryebashkiaku Erion Veliaj inspektoi përfundimin e punimeve dhe shtoi se investimet e bashkisë në institucionet arsimore rrisin cilësinë e mësimdhënies për të gjithë nxënësit. "Me 17 klasat e reja shkolla kalon me një turn, shpëtojmë nga klasat me dy turne, nga fëmijët që duhet të dalin vonë pasditë dhe të prishin gjithë ciklin biologjik, por edhe arsimor, duke iu përshtatur turneve të shkollës. Teksa hyjmë në këtë vit të ri shkollor, më vjen mirë që Kodër-Kamzës i është shtuar kjo stoli", -tha Veliaj. Ai theksoi se bashkia po vijon punën me të njëjtin përkushtim e cilësi, si në qendër edhe në periferi. "Fakti që punojmë me të njëjtën shpejtësi e



## RIKONSTRUKSIONI

"Me 17 klasat e reja shkolla kalon me një turn, shpëtojmë nga klasat me dy turne, nga fëmijët që duhet të dalin vonë pasditë dhe të prishin gjithë ciklin biologjik, por edhe arsimor, duke iu përshtatur turneve të shkollës. Teksa hyjmë në këtë vit të ri shkollor, më vjen mirë që Kodër-Kamzës i është shtuar kjo stoli", -tha Veliaj.

logjikë, dhe me të njëjtën cilësi, si në Kodër-Kamzë, ashtu edhe në qendër të Tiranës, tregon se sa të përkushtuar jemi për fëmijët e qytetit. Nuk ka fare rëndësi nëse jemi demokratë apo socialistë, rëndësi ka që për fëmijët të jemi të gjithë njësoj, të gjithë në një zë, me një fuqi, për t'u siguruar që marrin arsim të shëndoshë e nesër të jenë qytetarë shumë më të denjë, ndoshta edhe se raca jonë, për Tiranën që sot është bërë e stërmadhe dhe që Kodër-Kamza duhet të jetë pjesë dinjitoze", -shtoi Veliaj. Ai ftoi nxënësit të mirëmbajnë mjediset e reja të shkollës, por edhe ato të rikonstruktura, në mënyrë që bashkia të vijojë punën me të tjera investime. Veliaj vlerësoi vendimin e qeverisë për të dhënë librat falas për katër vitet e para të shkollës. "Librat falas, terrenet sportive, shkollë e re, tani na ngelen vetëm dhjetat dhe jam i sigurt që të gjithë djemtë e vajzat e Kodër-Kamzës do na bëjnë të ndihemi krenarë, që ia vlejti investimi, kur të shohim dëftesat e tyre në fund të vitit", -tha ai.

## Ahmeti: Përdorni transportin publik

Policia, masa shtesë për mbarëvajtjen e trafikut në ditën e parë të shkollës

Në kuadër të ditës së parë të fillimit të vitit të ri shkollor, policia rrugore në kryeqytet ka ndërmarrë një sërë masash për mbarëvajtjen e trafikut. Në një dalje për mediat Shefi i Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, Kryekomisar Erion Ahmeti, iu bëri thirrje të gjithë drejtuesve të mjeteve të shmangin sa më shumë përdorimin e autovecurave. "Komisariati rajonal i policisë rrugore në zbatim edhe të një plani masash të hartuara nga drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka marrë të gjitha masat duke planifikuar shërbimet shtesë për mbarëvajtjen e trafikut dhe mos ketë pengesa në rrjedhën e lirë të mjeteve. Policia rrugore bën apel të gjithë drejtuesve të mjeteve të shmangin sa më shumë të mundet përdorimin e autovecurave, të përdorin shërbimin publik për të çuar fëmijët e tyre në shkolla, pasi ajo është në funksion të të gjithë përdoruesve dhe të gjithë fëmijëve dhe në funksion të të gjithë trafikut për një rrjedhshmëri normale. Janë planifikuar shërbime në çdo degëzim dhe aks rrugor për të cilën ka densitet të shtuar të mjeteve. Janë marrë masa për shërbime shtesë për mos pasur bllokim trafikut", -tha Ahmeti.



## GJYKATA KUSHTETUESE KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

### SHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelitit pranë Gjykatës Kushtetuese (KPA), bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjykatëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit".

I - Shpall vendin vakant për pozicionin "Specialist Sekretarie Gjyqësore"

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

### KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidati duhet të sigurohet se plotëson kriteret për t'u pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidati duhet të ketë afësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 11 Shtator deri më 20 Shtator në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 20 Shtator 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 11 Shtator deri më 20 Shtator 2018 në adresën: info@kpa.al. KPA konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare; kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomatat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislativacionit në fuqi.
2. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
3. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
4. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
5. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
6. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 3, Tiranë, www.kpa.al, e-mail: info@kpa.al

## "Politikat fiskale të qeverisë, mundësi për zhvillimin e agroturizmit"

### Ministri Klosi në Festivalin e Verës në Berat

Në një atmosferë festive është hapur festivali i verës në Berat. I pranishëm në festën që këtë vit përkon me 20-vjetorin e njëres prej kantinave më të njohura ishte edhe ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Ministri Klosi tha se falë politikave fiskale lehtësuese të miratuara nga qeveria shqiptare biznesi i ka të gjitha mundësitë për të zhvilluar agroturizmin. Kjo për ministrin Klosi do të sjellë një rritje të ndjeshme të turizmit sikundër dëshmon edhe prania e mijëra turistëve në një nga kantinat më të njohura në Berat. "Qenia e kaq shumë turistëve dëshmon që sezoni nuk ka përfunduar dhe këtu në kantinën Çobo dëshmonet sesa shumë turistë kanë ardhur. 10 mijë turistë kanë shkelur kantinën vetëm gjatë 7 muajve të parë të vitit dhe kjo dëshmon që sa shumë kapacitete ka, për të



forcurar biznesin, për t'u lidhur me pushtetin lokal dhe për të krijuar rrjetin e agroturizmit në vendin tonë", -tha ministri Klosi duke shtuar se premtimi për festa lokale gjatë gjithë këtij sezoni turistik është përmbyshur. Kryetarja e bashkisë së Urës Vajgurore Juliana Memaj tha se implementimi i projektit të 100 fshatrave ka filluar në njësitë vendore me disa projekte të rilindjes së qendrave të fshatrave në këtë bashki dhe se do të vijojë puna për të zhvilluar agroturizmin.

"Edhe ne si njësi vendore duke qenë pjesë e vizionit me mundësitë që kemi të bëjmë të mundur realizimin e këtyre projekteve në bashkinë Ura Vajgurore. Në disa fshatra, projektet kanë filluar me rilindjen e qendrave të tyre dhe ne do të vijojmë punën që të bëjmë më të mirën për zhvillimin e agroturizmit në territorin tonë", -tha kryetarja e bashkisë. Të ftuarit, mes të cilëve shumë turistë të huaj dhe përfaqësues të trupave diplomatike, shijuan verën e kantine në shenjë mirëseardhjeje. Më pas festivali vijoi me vjeljen e rrushit nga të rinjtë të veshur me kostume tradicionale dhe me ritualin e shtypjes së rrushit nga vajzat e zonës. Festa vijoi me ceremoninë e 20-vjetorit të kantine së njohur në mbarë zonën për prodhimet e verës.



FSDKSH: Barnat me rimbursim, kush mund t'i marrë falas ose me 50% zbritje

# Pensionistët, zbardhen përfitimet nga sigurimet shëndetësore

## Të gjitha kategoritë që përfshihen në skemë



Voltiza Duro

Qytetarët që paguan kontributet për sigurimet shëndetësore, lu ndrejtë e përfitimit të rimbursimit të barnave si dhe mund të marrin disa shërbime mjekësore falas. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot përfitimet që mund të kenë pensionistët, invalidët e plotë apo dhe kategori të tjera individësh falë sigurimit shëndetësor. "Masa e kontributit të sigurimit të detyruar shëndetësor është 3,4% e bazës për llogaritjen e kontributeve. Për të punësuarit, kontributet paguhen, në masën 50% (pesëdhjetë për qind) nga punëdhënësi dhe në masën 50% (pesëdhjetë për qind) nga i punësuar. Si bazë për llogaritjen e kontributit shërben paga bruto e personit të siguruar", thekson Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Ky i fundit, gjithashtu, nënvizon se kontributi i shtetit për personat ekonomikisht joaktivë bazohet në konsumin për frymë të shërbimit shëndetësor, indeksuar me koeficientin e inflacionit.

### PËRFITUESIT

Çdo shtetas që paguan kontribut për sigurim shëndetësor, ose për të cilin paguan shteti, është i siguruar dhe përfiton nga skema e sigurimeve shëndetësore. Karta e Shëndetit është dokumenti i vetëm që vërteton se personi është i siguruar në skemën e sigurimeve shëndetësore. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe pagesa e kontributeve përkatëse janë të detyrueshme për të gjithë personat ekonomikisht aktivë, me banim të përhershëm në Shqipëri, si të punësuarit; personat e vetëpunësuar; punonjësit e papaguar të familjes; apo dhe persona të tjerë ekonomikisht aktivë. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor mbulon, gjithashtu, kategoritë e personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të përcaktuara me ligj. Në këtë kategori përfituesish bëjnë pjesë: personat që përfitojnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin përkatës; personat e regjistruar si të papunë-



### RIMBURSIMI I BARNAVE

"Më konkretisht për barnat, personat e siguruar, ose nuk paguajnë fare ose kanë një pagesë të pjesshme që shkon deri në 50% të çmimit të barnave, por jo më shumë. Kategoritë si: pensionistë, invalidë të plotë, fëmijë 0 - 12 muaj, të sëmurë me CA, TBC, të verbër përfitojnë falas alternativën e parë të çdo bari të përfshirë në listë", nënvizon FSDKSH.

"Masa e kontributit të sigurimit të detyruar shëndetësor është 3,4% e bazës për llogaritjen e kontributeve. Për të punësuarit, kontributet paguhen, në masën 50% (pesëdhjetë për qind) nga punëdhënësi dhe në masën 50% (pesëdhjetë për qind) nga i punësuar. Si bazë për llogaritjen e kontributit shërben paga bruto e personit të siguruar", thekson Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

punëkërkuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit; shtetasit e huaj azilkërkuar në Republikën e Shqipërisë; fëmijët nën moshën 18 vjeç; nxënësit e studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga veprimtari ekonomike; kategori personash që përcaktohen me ligje të veçanta; viktimat e trafikimit, sipas identifikimit të bërë nga strukturat e Ministrisë të Punëve të Brendshme si dhe personat e siguruar vullnetarisht.

### BARNAT E RIMBURSUESHME

Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen: vizitat mjekësore pa pagesë në institucionet shëndetësore publike; vizitën falas në banesë kur gjendja shëndetësore e të sëmurit nuk mundëson paraqitjen në institucionin shëndetësor; ekzaminimet mjekësore në institucionet shëndetësore publike; si dhe trajtimet mjekësore pa pagesë në spitalet publike. Gjithashtu, sigurimi i detyrueshëm mundëson

edhe shërbimet e paketave shëndetësore në institucionet shëndetësore private të kontraktuara me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; rimbursim të plotë ose të pjesshëm të barnave të Listës së Barnave të Rimbursueshme në varësi të kategorisë. "Më konkretisht për barnat, personat e siguruar, ose nuk paguajnë fare ose kanë një pagesë të pjesshme që shkon deri në 50% të çmimit të barnave, por jo më shumë. Kategoritë si: pensionistë, invalidë të plotë, fëmijë 0 - 12 muaj, të sëmurë me CA, TBC, të verbër përfitojnë falas alternativën e parë të çdo bari të përfshirë në listë. Kategoritë si: veteran dhe invalidë të luftës, përfitojnë falas në masën 100% të gjitha barnat e listës së rimbursueshme, si dhe të gjitha barnat e tjera të regjistruara në Republikën e Shqipërisë". Nënvizon FSDKSH. Pra, nëse jeni pensionistë, invalidë, veteranë, të punësuar, të vetëpunësuar, të siguruar vullnetarisht, fëmijë, gra shtatzëna, persona që trajtoheni me ndihmë ekonomike, punëkërkuar etj., me anë të kartës së shëndetit mund të përfitoni nga skema e sigurimeve shëndetësore, duke filluar nga receta e rimbursueshme, shërbimi të mjeku i familjes, të mjeku specialist, në qendrat spitalore, pra në të gjithë sistemin tonë shëndetësor publik.

### KATEGORITË PËRFITUESE

#### Persona ekonomikisht aktivë:

- të punësuarit;
- personat e vetëpunësuar;
- punonjësit e papaguar të familjes;
- persona të tjerë ekonomikisht aktivë.

#### Personat ekonomikisht joaktivë:

- personat që përfitojnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin përkatës;
- personat e regjistruar si të papunë- punëkërkuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit;
- shtetasit e huaj azilkërkuar në Republikën e Shqipërisë;
- fëmijët nën moshën 18 vjeç;
- nxënësit e studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga veprimtari ekonomike;
- kategori personash që përcaktohen me ligje të veçanta;
- viktimat e trafikimit, sipas identifikimit të bërë nga strukturat e Ministrisë të Punëve të Brendshme.
- Personat e siguruar vullnetarisht

### PËRFITIMET

- Vizitat mjekësore pa pagesë në institucionet shëndetësore publike, që financohen nga sigurimi shëndetësor dhe në respektim të sistemit të referimit;
- Vizitën falas në banesë - kur gjendja shëndetësore e të sëmurit nuk mundëson paraqitjen në institucionin shëndetësor;
- Ekzaminimet mjekësore në institucionet shëndetësore publike;
- Trajtimet mjekësore pa pagesë në spitalet publike;
- Shërbimet e paketave shëndetësore në institucionet shëndetësore private të kontraktuara me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- Rimbursimi i plotë ose i pjesshëm i barnave të Listës së Barnave të Rimbursueshme në varësi të kategorisë;
- Më konkretisht për barnat, personat e siguruar, ose nuk paguajnë fare ose kanë një pagesë të pjesshme që shkon deri në 50% (për qind) të çmimit të barnave, por jo më shumë.
- \*Kategoritë si: pensionistë, invalidë të plotë, fëmijë 0 - 12 muaj, të sëmurë me CA, TBC, të verbër përfitojnë falas alternativën e parë të çdo bari të përfshirë në listë.
- \*Kategoritë si: veteran dhe invalidë të luftës, përfitojnë falas në masën 100% të gjitha barnat e listës së rimbursueshme, si dhe të gjitha barnat e tjera të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

PËRVJETORI

Nga Ylli Polovina

# Konferenca e Pezës dhe çanta e fryrë e Enver Hoxhës

Disa të dhëna ndryshe nga ato zyrtare dhe pasaktësitë e shefit komunist

Deri në konferencën e parë të PKSH-së, të mbajtur në Labinot nga 17 deri në 22 mars 1943, ku u zgjodh Komiteti Qendror i përhershëm dhe Enver Hoxha sekretar i përgjithshëm i tij, ai për shtatëmbëdhjetë muaj qe thjesht "një anëtar i Komitetit Qendror". Ja pse thotë të vërtetën, pra jo si person që kishte përgjegjësinë e të parit të PKSH-së, kur në plenumin e dytë të mbajtur në Berat në fundnëntor 1944, deklaroi: "Unë s'isha në gjendje të mbroja tezën me nacionalistët. Unë dola të lexoja atë referat, por që të mbroj tezën jo. Me një përgatitje të tillë do të dilnin ato skena që dolën, do të dilnin gjëra qesharake. Kështu Konferenca e Pezës ka qenë sa për me lexue nga një referat dhe nga një trakt dhe pastaj ikëm".

Asnjë eksponent tjetër i Partisë Komuniste Shqiptare nuk ka bërë një deklaratë të tillë dekurajuese dhe zhvlerësuese për këtë Konferencë si Enver Hoxha. Ky do të veprime ndryshe duke filluar nga fundi i motit 1946: do ta rriste përherë e më shumë peshën politike të kësaj ngjarjeje dhe të rolit të parë të tij në të. Hoxha e lartonte veten për të ngritur Konferencën e Pezës dhe këtë të fundit reciprokisht për të gjigantizuar veten.

## KUR SHKOI NË PEZË, DHJETË DITË PASAKTËSI

Tek "Kur dhashë besën", botuar në 1987, Myslim Peza shkruan: "Më 1 shtator arritën delegatët e Dibrës e të Çermenikës. Nga Dibra erdhi Haxhi Lleshi, nga Martaneshi Baba Mustafa Xhani ose siç thirrej shkurt Baba Faja". Pas disa radhëve ai vazhdon: "Mbas katër a pesë ditësh...Te qoshku i shtëpisë, nën degën e arrës, u ndodhëm në krahët e njëri-tjetrit me Enver Hoxhën. Ardhja e shokut Enver na gëzoi të gjithë jashtëzakonisht. Ai u dha një hov të ri punimeve të konferencës".

Luftëtari e kaçaku i madh Peza, pa e përcaktuar drejt për së drejt datën konkrete (çfarë mund ta bënte, por është i detyruar t'i bëjë bisht), lë të nënkuptojë se Hoxha pati ardhur në vendngjarje rreth 5 shtatorit, pra pothuaj një duzinë ditësh më përpara se konferenca të niste punimet.

Në librin "Jeta ime me Enverin" Nexhmije Hoxha thekson: "Dhjetëditëshin e parë të muajit shtator delegatët që do të përfaqësonin Partinë Komuniste, shkuan në Pezë. Ata ishin Enver Hoxha, Ymer Dishnica, Koço Tashko, Ramadan Çitaku (Baca-kosovar), si edhe Mustafa Gjinishi...Për në Pezë u nis bashkë me shokët edhe Nako Spiru...Unë shkova në Pezë aty nga data 12 shtator".

Edhe shoqja e tij e jetës dhe e luftës çlirimtare e di fare mirë kur Hoxha u shfaq në fshatin e kuvendit të bashkimit pluralist të shqiptarëve, por e ndërton frazën shpjeguese në mënyrën më ngatërrestare dhe shpërqëndruese për vëmendjen e lexuesit. Sigurisht edhe ajo është e shtrënguar që për këtë fakt të mos jetë e drejtëpërdrejtë.

Në plenumin e dytë të KQ të PKSH në Berat Enver Hoxha pati pohuar për Miladinin: "Unë isha në Tiranë. Ai ishte në Pezë. Nuk kishim folur më përpara". Po ashtu: "Mora një letër, një pusullë ku më thoshte që të lajmëroja filanin e filanin se do të bënim konferencë". Më në fund thotë atë që në çështje të saktësimi të datave duhet të jetë e vërtetë, sepse mes pjesëtarëve të plenimit të Beratit ishin edhe shumica e shokëve që patën qenë të pranishëm në konferencën e para dy viteve dhe, po të ishte gjenjeshtrë çfarë po deklaronte, do ta kundërshtonin: "Kur shkova në Pezë qenë përgatitur referatet dhe i gjeta këta shokë që po grindeshin, po haheshin për një çështje me rëndësi që s'e mbaj mend ta vëmë këtë apo të mos ta vëmë. Pas një dite dolëm në Konferencë për të mbrojtur platformën tonë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare".

Me autorësinë e tij Enver Hoxha pohon se për të marrë pjesë në atë konferencë të organizuar kryesisht prej Miladin Popoviçit, ai ka qenë aty në paraditen e 15 shtatorit. Me pak fjalë, përveç dhjetë ditëve pasaktësi, nuk është aspak nga të parët.



Jo vetëm me prani, por siç do ta shohim më pas, edhe me rol politik.

## PSE KONFERENCËS NUK IU BË ASNJË FOTOGRAFI, QË KONSPIRACIONI APO FRIKË REALE PËR SPIUNIM?

Në "Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re" Enver Hoxha shkruan se në çastin para fillimit të punimeve të konferencës pjesëmarrësit e ngritur në këmbë kënduan Himnin e Flamurit dhe pastaj u mbajt një minutë heshtje në kujtim të të rënëve në Luftën Antifash-

iste, "Në këto momente hyri në dhomë një partizan i Çetës së Pezës me një aparat fotografik për të bërë disa fotografi, por, me këmbënguljen e Ndoc Çobës, nuk u lejua të fotografoheshin pjesëmarrësit e Konferencës".

Më pas ai nuk shpreh ndonjë dyshim dhe nuk bën posaçërisht ndonjë vërejtje rreth këtij gjesti, por gjithsesi jo më kot e vë në dukje. Nuk i ka pëlqyer. Këtë humor të prishur ne e gjejmë më të shprehur tek Myslim Peza. Në "Kur dhashë besën" ai shkruan: "Diskutimet se kush do ta udhëhiqte luftës

u banë çorap. Nacionalistët filluan të bëjnë teori e politikë të madhe me aleatë e stëraleatë. M'u duk se po lodheshim kot. Propozova të banim pushim. Dolëm jashtë. Në atë kohë shokët tanë të çetës deshën të na banin një fotografi, po delegatët "nacionalistë" patën frikë e u la kjo punë. Kështu mbetëm pa fotografi".

(Nexhmije Xhunglini në librin "Jeta ime me Enverin", pjesa e parë, e përshkruan këtë pushim, por nuk flet për ndonjë përpjekje të tillë fotografimi).

Vëmendja për t'i fiksuar në celuloid dhe me këtë rast historiografia kombëtare do të kishte një dokument më të gjallë për Konferencën e Pezës, pa e saktësuar nëse kjo ndodhi në çastet e paranisjes së punimeve apo gjatë pushimit të parë (ose në të dyja bashkë), të bën të mendosh se përreth ngjarjes vërtitej shumë dyshim për sigurinë fizike të pjesëmarrësve. Patjetër rreth e rrotull kishte shumë informatorë të italianëve. Myslim Peza dhe çeta e tij përjohej.

Ndoshta nacionalistët kundërkomunistë, mes të cilëve një pjesë ndodheshin me punë të ndryshme më afër autoriteteve të pushtimit, e njihnin këtë fakt edhe më mirë se njerëzit e PKSH-së ose, në mos merrnin të dhëna nga ky burim, dinin diçka rreth metodës së punës së bolshevikëve. Koço Tashko në një letër të tij për Kominternin, të hartuar, por të padërguar, referuar pikërisht kësaj konference, pati shkruar se "Kur raportet vijnin nga shokë që Miladini nuk i kishte në sy



të mirë, p.sh., raport të atyre që ishin ngarkuar me punë me nacionalistët, këto raporte mbahehin në arkiva të ekspozuara, e si rezultat ato ranë në duart e policisë... dhe disa nacionalistë u internuan dhe të tjerë u burgosën", siç ndodhi me figura kryesore të zgjedhura në Konferencën e Pezës e të tjerë".

## ENIGMA E ÇANTËS SË FRYRË TË ENVER HOXHËS

Edhe pse bën dinakërinë e tij të thënies së gjysmë të vërtetave të "Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re", atmosferën e fshehtësisë së lartë Enver Hoxha e përshkruan edhe kur, pas përfundimit të konferencës, u duhej të largoheshin: "Ndërkaq unë me disa shokë pasi mbaruan punët që kishim, vendosëm të ktheheshim në Tiranë. Udhëtimi duhej të bënte mënyrë tepër konspirative, sepse dyshohesh se armiku mund të kishte marrë vesh për mbledhjen dhe të kishte forcuar kontrollin...Babë Myslimi na premtoi se do të na giente një makinë me një shok të sigurt, i cili kishte kryer misionet e tilla edhe më parë, sidomos në periudhën e përgatitjeve për Konferencën e Pezës. Ky ishte një shofer i lidhur ngushtë me Partinë e me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, që më duket se e thërritin Meti [Muhamet Qoli].

Një ose dy ditë më pas, aty nga dreka, Meti erdhi me një "Mileçento", që ia kishte marrë borxh një mikut të tij, dhe, pasdite, u nisëm për në Tiranë së bashku me Y. Dishnicën e M. Gjinishin. Të tre ishim veshur si "intelektualë". Unë kisha vënë edhe një palë syze dielli të errëta. Në brez, në jelek mbaja na-

Në "Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re" Enver Hoxha shkruan se në çastin para fillimit të punimeve të konferencës pjesëmarrësit e ngritur në këmbë kënduan Himnin e Flamurit dhe pastaj u mbajt një minutë heshtje në kujtim të të rënëve në Luftën Antifashiste, "Në këto momente hyri në dhomë një partizan i Çetës së Pezës me një aparat fotografik për të bërë disa fotografi, por, me këmbënguljen e Ndoc Çobës, nuk u lejua të fotografoheshin pjesëmarrësit e Konferencës"





gantini, kurse në çantë kisha futur një "njëzetëshe". (Tek libri i tij "Kur dhashë besën" Myslim Peza këtë çast e përshkruan kështu: "Enver Hoxha u përgafua me ne, veshi xhakëtën e kostumit gri, vuri kasketën e syzet e errëta dhe na përshëndeti me grusht. Ai eci drejt veturës me një çantë të zezë në dorë ku mbante dokumentet, "njëzetëshen" dhe bombat e dorës. Në brez ai mbante të fshehur edhe një nagant").

Kuptohet që një çantë e tillë, siç e tregon luftëtari Peza, duhet të qe me volum të madh dhe tepër e dukshme, për këtë arsye edhe tepër e dyshueshme në rastin e një kontrolli policor apo ushtarak.

Por e lëmë një çast mënjë çantën e zezë të shumëfryrë të Enver Hoxhës dhe i rikthehemi rrëfimit të tij: "Në makinë, siç thashë, kishim edhe nja dy thasë me materiale, trakte dhe Rezolucionin e Konferencës.

Rrugën nga Peza deri në hyrje të Tiranës e kaluam pa incidente, por tamam kur kaluam postblllokun e menduam se s'kishte më rrezik, Tafari (Pseudonimi i Mustafa Gjinishit), pa u konsultuar fare me ne, i thotë shofërit:

- Ktheje andej!  
- Për ku? - e pyeta i habitur. - Do të na çosh tek italianët si çjapin të kasapi? - dhe i tregova me gisht kazermat që ngriheshin afër atij vendi ku atij i shkrepiti të futnin makinën.

- Kazermat janë larg, - m'u përgjigji qetë-qetë, - kurse fare afër prej këtej është hani i një mikut tim. Thasët me dokumente do t'i lëmë atje që në qytet të hyjmë pa asgjë të rrezikshme!

Nuk arrita dot t'i kundër-

shtoja, sepse makina frenoi para njëfarë hani të qelbur e thuajse të shkatërruar. S'mbetej tjetër veç të zbritnim me shpejtësi, i fshehëm thasët në një qoshe të hanit dhe u futëm në makinë.

Me sa duket qëndrimi ynë prej disa minutash aty tërhoqi vëmendjen e ushtarëve e të milicëve që s'ndodheshin larg dhe, kur ne u nisëm në drejtim të rrugës së Kavajës (sot "Konferenca e Pezës"), dy-tre karabinierë na bëjnë shenjë me dorë që të ndalojmë".

### KUR ENVER HOXHA IKU NGA PEZA, DITË TË TJERA PAQARTËSI

Hoxha saktëson ditën e kësaj ndodhie: "Ishte ditë e

shtunë dhe këtë ditë fashistët italianë e festonin; ushtarët e sidomos oficerët dilyn në qytet e kalonin kohën nëpër kafene e restaurante".

Prej kësaj hollësie ne mund të nxjerrim datën që rrefyesi nënkupton. Mbështetur tek shprehja "një apo dy ditë më pas", me një llogaritje të parë, duke qenë se kur filloi konferenca, në 16 shtator, qe e mërkurë, e shtuna e nënkuptuar me episodin e mëspërm është 19 shtatori.

Le të ndjekim tani ciklin e tregimit me gjysmë të vërtetat e Enver Hoxhës: "Për shkak të lëvizjes së madhe në rrugë na manovronim me vështirësi. Ndërkohë vumë rre që dy motoçikleta na



"Unë s'isha në gjendje të mbroja tezën me nacionalistët. Unë dola të lexoja atë referatin, por që të mbroj tezën jo. Me një përgatitje të tillë do të dilnin ato skena që dolën, do të dilnin gjëra qesharake. Kështu Konferenca e Pezës ka qenë sa për me lexue nga një referat dhe nga një trakt dhe pastaj ikëm"

ishin vënë prapa. Por Meti nuk ndali dhe me shkathësi diti t'u humbiste atyre nga sytë. Kështu i shpëtuan edhe këtë herë rrezikut të madh dhe arritëm të Kodra e Kuqe.

Të tërburar që s'na kapën dot, fashistët ishin kthyer në palo hani e Gjinishit, kontrolluan dhe i gjithë materiali që sollëm nga Peza (Rezolucioni dhe traktet) ra në duart e tyre...Më vonë mësuam se edhe Nako Spiru me dy shokë të tjerë, pasi ishin larguar nga Peza dhe shkollin në drejtim të Durrësit, ishin ndeshur në Ndroq me patrulla të armikut dhe ishin arrestuar. Me sa më kujtohet, Nakoja ndenji pak kohë në burg, sepse mundi të arratisë që andej".

Por Nexhmije Hoxha në kujtimet e veta nuk flet për ndonjë ndërlikim apo rrezikim të fatit të shefit të saj politik dhe njëkohësisht të përgjeshurit të zemrës. Po ta kishte përjetuar këtë moment si kërcënim apo edhe vetëm dëgjuar si të fillë, ajo nuk do ta anashkalonte në rrëfimet e saj. Ka të ngjarë që Enver Hoxha e zmadhon rrezikun a ndoshta episodin e tregon për të djallëzuar imazhin e Mustafa Gjinishit. (Po ashtu Xhunglini nuk tregon se kur dhe në çfarë rrethana edhe ajo vetë u largua nga Peza, duke u kthyer në Tiranë).

Tek "Kur dhashë besën" Babë Myslimi, siç e kemi paraqitur edhe më parë, ka treguar se pas mbylljes së konferencës të parët ikën nacionalistët dhe se "Enver Hoxhën e përçolla vetë deri në Pezë të Vogël. Bashkë me

të do të ktheheshin në Tiranë edhe komisar i ynë që nuk rrinte në Pezë, Mustafa Gjinishi dhe Ymer Dishnica. Ishte e shtunë pasditë, 26 shtator. E mbaj mend mirë këtë datë, sepse mbas dy ditëve, më 28, të hënë në mëngjes, na ranë fashistët".

Pra, paska qenë e shtuna tjetër! Hoxha është larguar nga Peza dhjetë ditë pas përfundimit të punimeve të konferencës! Ja pse ai këtë hollësi e shmang nga kujtimet e tij dhe i ndërton frazat në një mënyrë të tillë që të lërë të lexuesit përshtypjen se nga Peza ka ikur pa u vonuar.

Mirëpo dhjetë ditë qëndrim aty ku ka ndodhur ngjarja e rrezikshme për autoritetet e pushtimit, dëshmon se italianët, që e dinin çfarë pati ndodhur, nuk dëshmonin ndonjë mobilizim të veçantë për ta kapur Enverin. Në fund të fundit ai ende nuk qe shefi i komunistëve. Duke u bazuar në procesverbalin origjinal të konferencës, të mbajtur prej Nexhmije Xhunglini, ai e ka marrë fjalën dhe mbajtur referatin i trembëdhjeti në radhë.

### DHJETË DITË MË PAS AVIONË BOMBARDUES MBI PEZË

Babë Myslimi tek "Kur dhashë besën" ka paraqitur shumë hollësi rreth gjendjes së pas konferencës. Shoferi i "Millecento"-s që sollë në Tiranë Enver Hoxhën, Ymer Dishnicën dhe Mustafa Gjinishin, karabinierët italianë e arrestuan të nesërmen, në 27 shtator. I kishin mbajtur shënim targën e makinës që një ditë më parë. Dhe e

mbajtën në burg për një vit të tërë.

Sipas Myslim Pezës, një grup partizanësh prej një-sive të tij, izgjedhur prej vetë Nako Spiru, e patën shpëruar këtë të fundit "deri në Ndroq dhe qenë kthyer me kohë. Në fakt, Nakoja kishte rënë në duart e karabinierëve në të dalë të Ndroqit. U përpoq mjaft njësitë gueril i Durrësit për ta nxjerrë Nakon nga kuestura, por nuk ja dolën dot. E rregulloi i jati masandaj, ishte tregtar i madh, i bleu rojat me pare, dhe Nakoja u arratis nga çatia e kuesturës".

Në 28 shtator nisi sulmi masiv ushtarak italian kundër Pezës. Duke përdorur tërthorazi kur në të vërtetë është larguar nga Peza, Enver Hoxha tregon: "Dy-tri ditë pas largimit tonë nga Peza, italianët dhe forcat e qeverisë kuislinge filluan operacionin ndëshkues në këtë zonë. Fashistët, që tashmë kishin mësuar mbi mbledhjen e mbajtur atje, dhe duke e kuptuar rrezikun e një baze të tillë të Luftës Nacionalçlirimtare pranë Tiranës, kishin vendosur ta spastronin Pezën nga partizanët dhe simpatizantët e lëvizjes. 3000 forca italiane e kuislinge formuan një darë të fortë dhe u sulmën mbi Pezë".

Sipas kronikave të kohës sulmuesit përdorën deri edhe avionë bombardues. Këta goditën mbi çati edhe shtëpinë ku u mbajt konferenca, duke e djegur.

Tiranë,  
më 4 shtator 2018





## NJOFTIM PUNËSIMI

### POZICIONI I PUNËS: DREJTOR EKZEKUTIV I INSTITUTIT EUROPIAN PASHKO

INSTITUTI EUROPIAN PASHKO është një organizatë jofitimprurëse themeluar nga EEI / Iniciativa Europiane për Edukim, si agregim i më shumë se 10 viteve veprimtari në mbështetje të: lirisë ekonomike, inovacionit, lirisë së shtypit, botimeve dhe de batit të ideve, kreativitetit dhe të trashëgimisë kulturore. IEP udhëhiqet nga vlerat e aksionit afirmativ, europianizimit të shoqërisë shqiptare, reformizmit, liberalizimit ekonomik dhe politik, për nder të ideve të profesor Gramoz Pashko, emrin e të cilit mban ky institut, falë dashamirisë së familjes Pashko. / GRAMOZ PASHKO, profesor, ekonomist liberal, figurë sui generis intelektuale, një nga liderët e lëvizjes demokratike të "Dhjetorit 1990" dhe themeluesi i universitetit të parë privat në Shqipëri në vitin 2002. /IEP do të promovojë nëpërmjet gjashtë programeve vlerat e demokracisë liberale, ekonomisë së lirë të tregut dhe europianizimit.

#### DOKUMENTET E KËRKUARA

CV e hollësishme  
Diplomë Master Shkencor / PhD / Certifikata të ndryshme

#### KRITERET

Të ketë përfunduar studimet në Shkenca Politike/ Juridik / Shkenca komunikimi / Menaxhim / Marketing ose në fusha të përafërta. Të ketë afësi shumë të mira komunikimi dhe strategjike për negociim me të tjerët. Kandidati duhet të jetë i aftë të ndërtojë marrëdhënie me palët e interesuara, partnerët e IEP, institucione jo-qeveritare dhe qeveritare, institucionet rregullatore dhe mediat. Gjithashtu duhet të ketë eksperiencë në zhvillimin strategjik dhe zbatimin e modeleve të anëtarësimit dhe kodet e sjelljes, si dhe të ruaj një vlerësim të lartë të rëndësisë së markës dhe objektivave të organizatës që drejton

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit brenda datës  
20 Shtator 2018, ora 15.00, në adresën: [kebjana.haka@uet.edu.al](mailto:kebjana.haka@uet.edu.al)



PROGRAMET E INSTITUTIT EUROPIAN PASHKO



## DO TË JESH PJESË E STAFIT AKADEMIK TË UET? APLIKO TANI!

### I UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS REKRUTON STAF NË FUSHAT:

1. Shkenca Ekonomike
2. Shkenca Juridike, Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
3. Shkenca Humane, Edukimi dhe Arte Liberale
4. Shkenca të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës
5. Shkenca Mjekësore Teknike

### II DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PEDAGOGUT

1. Mësimdhënie në tre ciklet e studimit BA/MA/DR
2. Këshillim i studentëve
3. Angazhimi në veprimtari kërkimore - shkencore
4. Mbështetje për institucionin

### III KRITERET E NJË KANDIDATI TË SUKSESSHËM

1. Preferohet që kandidati të ketë përfunduar të paktën një cikël studimesh (BA/MA/DR) në një universitet anglo-sakson.
2. Të jetë i aftë të garantojë cilësinë, efikasitetin dhe ekselencën e zhvillimit të lëndëve që do të japë dhe t'i përgjigjet me fleksibilitet nevojave të universitetit;
3. Të ketë përvojë në mësimdhënie në shkollën e lartë dhe në fushën e kërkimit shkencor të mirëfilltë.

### DOKUMENTET E KËRKUARA

- #### IV
- CV e hollësishme e kandidatit në gjuhën shqipe.
  - Letër motivimi në të cilën të shpjegohen qartë interesat profesionale, fushat e ekspertizës dhe lëndët e synuara.
  - Kopje të listës së notave, shoqëruar me diplomën përkatëse të ciklit të parë dhe të dytë. (notë mesatare mbi 9-të).
  - Kopje të dëshmisë së gradës shkencore/ titujve akademikë
  - Për studimet e kryera jashtë Republikës së Shqipërisë, diploma duhet të jetë e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin.

-Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në: [hr@uet.edu.al](mailto:hr@uet.edu.al) ose në zyrën e Burimeve Njerëzore deri më 20 Shtator 2018.

-Konkursi zhvillohet në datat 26-27-28 Shtator 2018

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, [info@uet.edu.al](mailto:info@uet.edu.al)



FAKULTETI I EKONOMISË BIZNESIT DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE JURIDIKE POLITIKE DHE MARRËDHËNIEVE NDERKOMBËTARE

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE EDUKIMIT DHE ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI I INXHINIERISË INFORMATIKËS DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE







## MJEKU POPULLOR



Kura  
me bimë medicinale që  
parandalon virozat  
e stinës

## KESHILLA



Pse duhet të  
konsumoni rregullisht  
vaktet ushqimore

# Megina Laçka:



Dermatologia:  
Kujdes me  
konsumimin e  
tepërt të  
yndrave,  
armik i flokut  
tuaj

## Si të trajtoni flokët e djegurur nga plazhi

"Maska ideale që mund  
të përdorni në kushte shtëpie"

**Drithërat që parandalojnë diabetin e tipit 2**

Dermatologia: Kujdes me konsumimin e tepërt të yndyrave, armik i flokut tuaj

# Megina Laçka: Si të trajtoni flokët e djegur nga plazhi

*"Maska ideale që mund të përdorni në kushte shtëpie"*

Voltiza Duro

**F**lokët janë gjatë gjithë kohës të ekzpozuar ndaj faktorëve të jashtëm mjedisore dhe kjo i bën ata më delikatë. Në këtë periudhë në vjeshtë shumë nga ne ankohen për flokët e dëmtuar, për flokë që bien, për flokë pa jetë dhe shkëlqim. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", dermatologia, njëkohësisht biokimistja Megina Laçka jep disa këshilla të vlefshme për flokë të bukur, të fortë e plot shkëlqim.

**Cilat janë disa prej faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e flokut të njeriut?**

Ashtu si lëkura jonë dhe flokët kërkojnë një kujdes të veçantë që të jenë më të shëndetshëm dhe më të fortë. Gjenetika luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e flokut, por edhe regjimi ushqimor ka një ndikim të madh.

**Çfarë diete ushqimore duhet të ndjekim për të mos pasur probleme me flokët?**

Duhet që të kemi një dietë ushqimore të pasur me vitamina, minerale dhe proteina. Një deficit ushqimor dhe rënia e flokëve janë fenomene, të cilat mund të zhvillohen së bashku për një kohë të gjatë nëse një ose disa minerale jetësore mungojnë në dietën tonë ushqimore si hekuri apo jodi. Mungesa e këtyre mineraleve në organizëm shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë rënien e flokëve dhe ky është një problem që shfaqet si te femrat dhe meshkujt. Gjithashtu, një dietë e pasur me kalori mund të jetë shkaktare ose nxitëse për rënien e flokëve.

**Si ndikon konsumimi i tepërt i yndyrave?**

Prodhimi dhe balancimi i hormoneve në organizëm

ka gjithmonë lidhje me ushqimet që konsumojmë sidomos me yndyrat e ngopura. Yndyrat janë të dëmshme jo vetëm për shëndetin tonë, për lëkurën por edhe për flokët. Yndyrat e ngopura e kanë prejardhjen nga mish i kuq, bulmeti. Këto yndyra të ngopura ndikojnë në rritjen e nivelit të kolesterolit LDL (kolesteroli i keq), ndërkojnë që kolesteroli HDL (kolesteroli i mirë) e ka prejardhjen nga yndyrat e pangopura. Yndyrat e ngopura lidhen me prodhimin e hormonit DHT (hormon që nxit në rënien e flokëve) dhe sebumit e cila e nxitur nga hormone DHT bllokoi folikuat e flokëve duke penguar kështu daljen e flokut të ri. Gjithashtu, dhe konsumimi i lartë i karbohidrateve, proteinave dhe ushqimeve të tjera me përmbajtje yndyrore mund të konvertohen në yndyra të ngopura duke sjellë kështu dëmtimin e flokëve.

**Cilat janë disa nga rekomandimet tuaja për të pasur flokë të shëndetshëm, veçanërisht pas periudhës së plazhit?**

Për të pasur flokë të bukur gjatë kësaj periudhe post plazhi dhe gjatë gjithë kohës duhet të jemi gjithmonë të hidratuar dhe të konsumojmë sa më shumë fruta dhe ujë. Unë do të sugjeroja, gjithashtu, trajtimin e flokëve dy herë në javë me maska në kushte shtëpie ose me produkte bimore organike. Duhet të tregoni kujdes me krehjen e flokëve dhe furçën që përdorni pasi nuk



Megina Laçka

duhet ta dëmtoni apo këpusni flokun. Serumet e flokëve apo zbutësit e flokut në verë duhet patjetër që të kenë filtra mbrojtës ndaj rrezatimeve UVA-UVB pasi jemi të ekspozuar gjatë gjithë kohës ndaj rrezeve të forta të diellit. Ky kujdes nuk duhet të mungojë as në dimër pasi ne të kundërt mund të ndodhë dehidratimi dhe tharja e

flokut. Një kujdes i veçantë duhet treguar me tharjen e flokut pasi asnjëherë nuk duhet të përdorim nxehtësi të lartë për modelimin e flokut ose ta thajmë plotësisht atë.

**Si duhet bërë larja e flokëve?**

Këshilla ime më kryesore lidhet me mënyrën sesi i lani flokët tuaj. Nuk duhet tepruar asnjëherë me shampun pasi duke e përdorur në

sasi të lartë prishet balanca yndyrore dhe hidrike e flokut. Gjatë aplikimit të shampos masazhimi i skalpit e detoksifikon atë dhe nxit qarkullimit e gjakut duke ndikuar kështu në rritjen e flokut.

**Ku duhet të bëjmë më shumë kujdes për të mos shkatërruar flokun?**

Flokët janë shumë delikatë prandaj gjithmonë duhet të tregojmë kujdes të veçantë ndaj rrezeve të diellit, kimikateve të ndryshme si përqindja e lartë e klorit në pishina, produktet dhe trajtimet për shtrirjen apo strukturimin e kaçurrelave si dhe bojatë e ndryshme me përqindje të lartë amoniaku. Të gjitha këto të përdorura në sasi të lartë sjellin dëmtimin, dobësimin dhe këputjen e flokëve.

**Cilat janë disa prej maskave në kushte shtëpie që ju këshillojmë për të rigjeneruar flokët?**

Unë sugjeroj gjithmonë trajtimet natyrale për flokë plot jetë dhe shkëlqim. Një problem tjetër janë majat dyshe të flokëve, mos u gënjëni asnjëherë pasi ato vijnë nga dëmtimi i flokut për një periudhë të gjatë kohore dhe nuk trajtohen ato vetëm mund të prisni për të shmangur dëmtimin e mëtejshëm të tij. Po ju sugjeroj një maskë bimore e përshtatshme për të gjitha tipet e flokëve e cila rigjeneron flokun, i jep shkëlqim dhe forcon rrënjën. Mjafton të përgatisni në blender një banane të pjekur me 2 lugë vaj ulliri, aplikojeni në flokë për 30 minuta. Mund ta aplikoni 1-2 herë javë.







Voltiza Duro

Mjeku Popullor: Simptomat kryesore që nuk duhet t'i neglizhoni, si duhet të veproni

Vetë ndryshimi i klimës dhe luhatjet e temperaturave, bën që virozat dhe bakteriet që janë të pranishme në ajër, të shfaqen dhe të gjallërohen në trupin e njeriut. Ato mund të kalojnë në organizëm në mënyrë të pandërprerë çdo ditë e kur kalojnë në gjak, fillon shtimi i tyre. Virusit qëndron në gjendje qetësie për 3, 4 apo 5 ditë dhe pastaj shpërthen. Njeriu që kapet nga virozat, 2-3 ditët e para fillon të ketë ndonjë këputje, lodhje, dhimbje kockash, kyçesh e kështu me radhë. Më tej, fillon një rritje e lehtë e temperaturës. Ndërsa kur pacienti ka temperaturë e kollitë të menjëhershme, marrje mendsh, prerje oreksi, vështirësi në frymëmarrje e dhimbje koke, kjo do të thotë se është prekur nga i ftohti. Pra, është tjetër virusi, pavarësisht tipit që ka; dhe është tjetër i ftohuri. Virusit zgjat deri në 7 ditë, ndërsa ftohja për një kohë më të gjatë.

**VIRUSET DHE FTOHJA**  
Për të minimizuar ciklin e virozës që zgjat deri në javë duhet të ndjekim disa hapa të dobishëm. Së pari, duhet të rrisim rezistencën e organizmit, kjo është pikënisja. Nëse ndjehmë menjëherë një rënie të ndjeshme të temperaturave nuk duhet të vishemi shumë trashë, por duhet të bëjmë dush në mëngjes me ujë të ftohtë, e pasuar me ushtrime gjimnastike rreth 15 minuta, në mënyrë që të rrisim rezistencën e organizmit. Madje, në mëngjes duhet të pimë një gotë çaj me fruta pylli, trëndafil të egër apo pak lëng limoni. Kështu që kur të sulmohemi nga viruset, leukocitet do të jenë shumë më shumë "luftarake" dhe organizmi në këtë mënyrë bëhet më i fortë nga virozat. Nëse bëjmë një shpëlarje të pjesës së krahërorit e këmbëve me ujë të ftohtë, praktikojmë gjimnastikën e pimë disa prej çajrave të sipërpërmendur, atëherë edhe i ftohti është më pak kërcënues për organizmin. E rëndësishme është që temperatura e dhomës të jetë 5-6 gradë më e lartë sesa temperatura e ambientit të jashtëm. Duhet theksuar këtu, që ajri nuk duhet të thahet e dyshemeja duhet të spërkatet dy herë në ditë. Të gjithë njerëzit, për të forcuar imunitetin, duhet të përdorin

# Ylli Merja:

## Kura me bimë medicinale që parandalon virozat e stinës

"Përdorni trëndafilin e egër e lëngun e limonit"



Ylli Merja

bimë që janë të pasura me vitaminën C si boronica, trëndafil i egër, molla e egër, kulumbria, thana, dëllinja. Nëse këtë çaj e shoqërojmë me mjaltë, organizmi do jetë më në formë dhe organet do të punojnë shumë më mirë.

### ALERGJITE

Alergjitë shkaktohen nga viruset të ndryshme, por më e keqja, nga sa unë konstatoj është fakti që të gjithë njerëzit alergjikë, ose kanë myk në organizëm, në gojë, duar, trup etj., ose kanë ndonjë infeksion viral, të cilët hynë në simbiozë e bashkëjetojnë me

trupin duke i marrë ujin dhe kripërat minerale. Pikërisht në këtë situatë, imuniteti, rezistenca bie. Këta agjentë patogjenë të jashtëm fillojnë të krijojnë irritime në lëkurë e skuqje të syve. Shkaktari kryesor është myku e i sëmuri paraprakisht duhet të kontrollojë gjuhën, e nëse kjo e fundit është si me pluhur të bardhë, atëherë ka myk në mënyrë të padiskutueshme. Ka rreth 150 lloje të tillë, e kur organizmi është si i dobët e numri i leukociteve bie poshtë 3500-ës, njeriu duhet të marrë masa, sepse mushkëritë janë të predis-

pozuara për t'u kapur nga sëmundjet. Individit i prekur nga myku në gjuhë, çdo mëngjes duhet të marrë pak sodë buke të përzier me mjaltë, e me një garzë të pastrojë gjuhën, e më pas ta shpëtojë me një gargarë me ujë me sodë. Më tej duhet të përdorë një çaj antimykotik si ai i rigonit, ose gjethet e mushmollës. I sëmuri duhet të bëjë kujdes edhe me ushqimet, sidomos nga sheqernat apo majanë.

Mungesa e jodit

Në përgjithësi njerëzit që kanë mungesë jodi duhet ta "lidhin" jetën e tyre me pemën e arrës, pra duhet të konsumojnë arra të pabëra të vendosura në mjaltë e të ekspozuara në diell për 40 ditë resht. Një kokërr në javë është e mjaftueshme për të stabilizuar sasinë e jodit në gjak. Gjithashtu, pacientët që hasin mungesë jodi, mund të përdorin një çaj me gjethet e arrës.

### PARANDALIMI I VIROZAVE DHE FTOHJES:

- Nuk duhet të vishemi shumë trashë
- Duhet të bëjmë dush në mëngjes me ujë të ftohtë
- Duhet të bëjmë ushtrime gjimnastike rreth 15 minuta në ditë
- Në mëngjes duhet të pimë një gotë çaj me fruta pylli, trëndafil të egër apo pak lëng limoni.
- Temperatura e dhomës të jetë 5-6 gradë më e lartë sesa temperatura e ambientit të jashtëm.
- Ajri nuk duhet të thahet
- Dyshemeja duhet të spërkatet dy herë në ditë.
- Konsumoni bimë që janë të pasura me vitaminën C si boronica, trëndafilin i egër, molla e egër, kulumbria, thana, dëllinja.

# Këshilla



## Pse duhet të konsumoni rregullisht vaktet ushqimore

Mënyra e të ngrënit, plani i fikimit, koha dhe frekuenca e vakteve janë elementë të pandashëm të një stili jetese të shëndetshme. Një stil i tillë në vetvete e bën njeriun më pak të rrezikuar nga sëmundjet e zembrës, diabeti apo ishemia. Këtë e thotë një dokument shkencor i publikuar në revistën *Circulation*, një publikim i Shoqatës Amerikane Të Zembrës. Sipas kësaj analize, koha dhe mënyra e të ngrënit ndikon në faktorët e rrezikut për sëmundjet e zembrës dhe ishemisë. Si pasojë e stilit kaotik të jetesës, njerëzit nuk i përmbahen rregullit të tri vakteve në ditë. Ata përshtaten me aq vakte sa mund të përballojnë gjatë ditës. Kjo do të thotë, se në vend të të ngrënit një drekë të shëndetshme, shumë njerëz mjaftohen me diçka të shpejtë. Një ushqim i shpejtë nuk është domosdoshmërisht i shëndetshëm.

Marie Pierre St-Onge, eksperte e Mjekësisë Ushqimore në Universitetin e Kolumbias në Nju Jork, shpjegon se oraret e ngrënies kanë efekt tek

shëndeti. Sipas saj ato ndikojnë tek ora e brendshme e trupit. Për shembull, nëse njeriu ushqehet gjatë një faze jo aktive siç është gjumi, ora e brendshme ndërrohet duke ndryshuar metabolizmin e ushqyesve. Në këtë mënyrë, njeriu mund të shtojë më shumë në peshë dhe të jetë i prekur nga inflamacioni. Mëngjesi është padyshim vakti më i rëndësishëm i ditës, por njerëzit sot nuk kanë shumë kohë për t'u ulur në tavolinë e për të ngrënë siç duhet. Studimet kanë konfirmuar se heqja dorë nga mëngjesi rrit rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare e shumë të tjerave. Përveç kësaj, këto sëmund-

je janë më të pranishme tek njerëzit që nuk janë të vëmendshëm ndaj orareve të ngrënit. Nëse njeriu i përmbahet orareve të ngrënies së mëngjesit, drekës dhe darkës, mundet të parandalojë mbi-peshën, sëmundjet e zembrës dhe diabetin. Studimet thonë se njeriu duhet të jetë i vëmendshëm ndaj planifikimit të vakteve dhe përzgjedhjes ushqimore. Në këtë mënyrë, njeriu mund të shmangë ushqyerjen e nxitur nga emocionet. Këto të fundit nxisin shumë episode të pakëndshme të ngrënies së tepërt, pavarësisht mungesës së urisë. Një gjë e tillë rrit numrin e kalorive të marra. Nga ana tjetër ul sasinë e ushqyesve të domosdoshëm për mbarëvajtjen e organizmit.



## Drithërat që parandalojnë diabetin e tipit 2

Një studim shkencor i kohëve të fundit sugjeron se njerëzit që hanë më shumë drithëra të plota çdo ditë janë më pak të rrezikuar nga diabeti i tipit 2. Për disa vite me radhë, shkencëtarët e Universitetit Chalmers në Gothenburg analizuan të dhënat e 55 mijë njerëzve për të kuptuar ndikimin e drithërave të plota te kjo sëmundje. Shkencëtarët arritën në konkluzionin se ngrënia e çdo lloji drithi në ditë e mban larg sëmundjen e diabetit të tipit 2. Megjithatë sipas tyre njerëzit që konsumojnë të paktën 50 gramë drithëra të plota në ditë janë ndjeshëm më pak të rrezikuar. Këtu përfshihet edhe një racion me tërshërë ose një fetë bukë me drithëra të plota. Rreziku i shfaqjes së diabetit është 22 përqind më i ulët tek gratë. Ai është 34 përqind më i ulët tek meshkujt që hanë drithëra të plota çdo ditë. Rezultatet e këtij studimi interesant, nënvizojnë këshillat e përsëritura të shkencëtarëve për parandalimin e diabetit. Ato rekomandojnë heqjen dorë nga produktet e brumit me miell të bardhë dhe zgjedhjen e ushqimeve me drithëra të plota. Sipas tyre, mielli i bardhë ka ndikime negative në shëndet dhe nxit shfaqjen e diabetit dhe sëmundjeve. Drithërat e plota nga ana tjetër, jo vetëm që parandalojnë diabetin e tipit dy, por kanë edhe ndikime të tjera pozitive në shëndet. Në mesin e ndryshimeve të nevojshme për shmangien e diabetit, ekspertët kërkojnë shmangien e mishit të kuq. Sipas tyre, mishi i kuq rrit rrezikun e shfaqjes së diabetit dhe sëmundjeve kardiovaskulare. Ka njerëz që i shmangin drithërat me idenë se ato janë shumë të pasura me karbohidrate, por ekspertët thonë se drithërat e plota janë ideale për organizmin.



Reportazhi / Ditës

# Praga, tundimi për të jetuar ende në shekullin e alkimistëve

Nga Monika Stafa

(vijon nga faqja 1)

... Pragë. Ndjesia që më përshkonte mendjen ishte e trazuar dhe kjo e bënte të vështirë zgjedhjen e lojit të librit. Ajo që kuptova pas ca ishte një libër i hollë që m'u gjet ndër gishtërinj, në kopertinën e të cilit dalloheshin ca thonj të hollë gruaje. Cvajg mendova, rrotullohem ngado dhe nuk i shpëtoj dot dëshirës për të qenë me të, sa herë kam shkak të arratisem prej tiranisë njerëzore që sjell të menduarit gjatë. Ora për t'u nisur kish ardhur.

Pragë, si prag lindjeje, prag vdekjeje, prag krishtilindjesh apo dhe si prag nominimesh e rikthimesh. Ishin këto fraza, në fakt, që papritur më erdhën ndër mend sapo avioni bëri uljen e tij. Dhe të gjitha këto aksione njeriu i fiton vetë, i jeton vetë dhe po aq i ç' meriton vetë. Sepse mesa duket pragu është kaluar ose më mirë, ai është shkelur. Por jo caku, ama. Ç'mu gjet kjo lloj simbioze e çuditshme, pikërisht tani?! Gjithmonë atëherë kur ti do të lidhësh një emër çfarëdo, me kuptimin e tij ose edhe me rrënjën e tij të doni. Dhe kjo nuk ka të bëjë fare me dritat që shkëlqejnë poshtë lartësisë së reve apo dhe me ndriçimin që shqëron gjithmonë rrugët ajrore sapo kalohet kufiri territorial. Kufiri, ai që shumë shpejt nga shtetërorë në hartë, kthehet në administrativ. Pragën nuk kisha shumë kohë që e kisha vizituar. Një rrjet europian mbi kujtesën historike të kontinentit, mbajti një simpozium madhështor në kryeqytetin çek, me temë "Europa mes Luftës dhe Paqes 1914-2014; Pikat e kthesës". Qe një ngjarje e madhe në atë kohë, profesorët të njohur edhe nga SHBA morën pjesë aktivisht në shpalosjen e platformave të tyre mbi ngjarjet më të rëndësishme të historisë europiane të shek. XX-të. E ja ku u gjenda prapë, e nuk them se e kam njohur atë edhe pse kjo mund të jetë e shtata apo e teta herë që e vizitoj. Sepse me sa duket, vendet, ashtu si dhe gratë, duhet t'i njohësh kur sapo zgjohen nga gjumi. Të gjitha këto mendime më tirreshin në kokë ndërsa shënjoja me kaligrafi të shpërgenduar ndërmë faqeve, rreshtat që më



linin mbresë.

Ishite e folura klasike e stjuardesës që më shkëputi vëmendjen nga ky lloj triplanësh meditimi, për t'u bërë gati të mendoja zbritjen prej avionit. Asgjë më shumë veç muzikës së altoparlantëve dhe fytyrës së qeshur të tyre me buzët e kuqe, veshur me uniforma nuk shihje tjetër në sfond. Një pamje ishte kërkova ndër mend. Portreti i dashur i filmit në bardh e zi "Ushtari i mirë Shvejk", më preku dashamirësisht për ta pritur me buzëqeshje fëmije, ajrin e Pragës. Në aeroport, njerëzia ishte dyndëse. Diku një grup që harbonte me gëzimin e vet ndërsa diku tjetër në rrëmujë e sipër, disa të rinj gulçonin nën gazin që të sjell gota e dytë apo e tretë e birrës. Por ajo që më ra në sy, një detaj të cilin nuk e kisha harruar me sa duket ishte fakti që në Pragë është një gjë e zakonshme të shohësh gra me pantallona, kryesisht me uniformë të plotë, me këmbishë, kravatë e këpuce burrash, si dhe me një topuz të fshehur nën kapelë. Bënte vapë. Mania ime për të gjetur ngjashmëri në cilindo personazh të Hashekut me fytyrat çeke, sa herë zbrisja në Pragë, më bëri t'i thërrisja e buzëqeshur, një burri të stërmadh në përmasa, i cili

në qejfin e tij po rrëkëllente gotën e mbushur me birrë të zezë: Hello, Mr. Shvejk. Ai sakaq i dyzuar, pasi pa se nuk kish njeri tjetër rrotull, ma ktheu po aq në lirinë e tij të plotë: Ej, jo Mister Shvejk, ushtari Shvejk, duke më korrigjuar, në fakt, jo pa qëllim.

E di, ia ktheva qesëndisë për ta mbrojtur mirë atë që i kisha thënë, por ushtari juaj Shvejk, mendoj e besoj se ishte vërtet një zotëri. Ha, ha, qeshi ai, dhe rrëkëllente gotën e stërmadhe të birrës që s'dihej ku e kish fundin. Në fakt nuk kish për t'u menduar shumë për këtë vend. Ishim rritur me filmin dhe librin e Hashekut, me personazhin e dilirë me emrin Shvejk, i cili pohonte me ndershmëri se quhej Shvejk, sepse kështu i quhej nëna dhe babai, dhe nga ky rregull duhej patjetër të quhej edhe ai kështu. Qesha me

vete kur e mendova këtë gjë nialitet kaq të brishtë të ushtarit çek, që nuk ish aq bu-dalla kur shpjegonte këtë fenomen pavarësisht se kjo mendje e tij e çoi të ishte banor i një tjetër ambienti që ai e superoi me sukses, spitalin psikiatrik. Dhe duket se ky popull gjithë historinë e vet e ka përshkuar duke qeshur. Këtu ka kuptim të vërtetë ajo që dëshironin filozofët antikë grekë: "Të ndaheh nga e kaluara duke qeshur". E qeshura prej tërmeti e ushtarit të mirë Shvejk shkatërroi perandorinë më të madhe të kohërave moderne, perandorinë austro-hungareze. Devocioni "in extremis" i sh-tetasi "sherr-budallë", siç e kanë cilësuar shpesh studiuesit, me ngulimin e tij për të nxjerrë certifikatën e lindjes dhe për të lënë spitalin në emër të "thirrjes së atdheut", si çdo stërzm-

dhim tjetër, dërrmoi edhe autoritetin e kurorës së perandorit sovran.

Kisha mbërritur në hotel papritur. Mendimet mbi kujtesën historike të librit të Hashekut më kishin përfshirë megjithëse kolegët po më pyesnin për të disatën herë se në kisha dëshirë të darkoja ma ta. Një grua e shërbimit në reception ma bëri me shenjë se nuk mund të ngjitesha për sa kohë nuk qenë kontrolluar e verifikuar mirë pasaportat edhe në një sportel tjetër. Dy të rinj i qëndronin në koka. Dukeshin të sjellshëm, e me uniforma verore të përsosura, të lehta dhe të rehatshme. Më tej shokët kishin porositur pije të freskëta, birra të shkëlqyera çeke, të cilat erdhën me kuti me një shënim të shtypur: "Prishe kutinë pas përdorimit". Këto masa higjienike ndiheshin kudo në ditë në vijim. Restorantet në Pragë janë të pastra e me dritë ndërsa tualetet janë më të mira, thonë se, në çdo vend tjetër të Europës Perëndimore.

Të nesërmen udhëtimi me autobus na rrëshqiti përmes një zone bujqësie të mekanizuar, ku duket se ishte shfrytëzuar çdo centimetër. Gjithkund shihje vepra gjigande të inxhinierisë hidraulike, të përdunuar ose në

ndërtim e sipër. Afër Pragës, arat e mbjella u zëvendësuan nga gendrat industriale. Dikur kisha lexuar se Çekosllovakia furnizonte me makineri shumë vende perëndimore dhe krejt botën socialiste, përfshi dhe Bashkimin Sovjetik. Gjatë periudhës komuniste, në këtë vend regjisorët e teatrove dhe mjekët merrnin rroga tepër të larta. Shteti i arsimonte, i specializonte dhe pastaj i paguante me rroga shumë të larta që ata të mos emigronin në Perëndim. Dhe për hir të së vërtetës gjatë vizitave të mia në Pragë, nuk kam arritur të dalloj asnjë çek gjatë bisedave me ta, që të mos ishte deri diku i kënaqur me fatin e tij gjatë periudhës së kaluar. Madje edhe ata që në atë kohë ishin studentë, dhe sot janë zotërinj të mëdhenj, thuajse nuk e shprehnin pakënaqësinë e tyre për kontrollin e panevojshëm ndaj letërsisë dhe shtypit të huaj.

Udhëtimi me autobus na kish sjellë në ditën e dytë të trajnimit mbi sfidat që po haste media në përgjithësi përballë lajmit të rremë. Një temë tunduese këto kohë që kërkon përgatitje të mirë edukative dhe arsimore. Atë mëngjes, Praga ish gjendur nën një shi të imët, por qyteti shfaqej i gjallë, i harehëm dhe jetonte një mëngjes të mrekullueshëm vere. Takimet me ekspertët zgjatën deri vonë pasdite. Shkëmbimi i ideve për ta çuar më tej nisimën e bashkëpunimit përmes një rrjeti profesionistësh ishte gjithë qëllimi i grupit të përbashkët. Darka na u shtrua me një verë të shkëlqyer franceze, për të cilën zotërinjtë e tryezës thanë se nuk e gjen me atë çmim as në restorantet e lira të Parisit. Në mesnatë përshkrum qendërën e qytetit. Në kafenet e bulevardit 'Wenceslas', një fjiollë sfondi muzikor përziehe me pëshpëritjet e turmës që dilte nga kinemaja dhe nga teatri.

Praga i ka asimiluar ndikimet më të patretshme pa u shëndosur tepër. Është një zgjidhje e mesme, e ruajtjes së anëve më të mira të së vjetrës dhe e anëve më normale të së tashmes. Askush nuk është përpjekur t'i falsifikojë për t'u bërë përshlyetje turistëve. E tillë është Praga, vjetërsia e saj është tundimi për të jetuar ende në shekullin e alkimistëve.

Pragë, si prag lindjeje, prag vdekjeje, prag krishtilindjesh apo dhe si prag nominimesh e rikthimesh. Ishin këto fraza, në fakt, që papritur më erdhën ndër mend sapo avioni bëri uljen e tij. Dhe të gjitha këto aksione njeriu i fiton vetë, i jeton vetë dhe po aq i ç' meriton vetë. Sepse mesa duket pragu është kaluar ose më mirë, ai është shkelur.

## RREFIMI KRIMET E KOMUNIZMIT

Ekskluzive për "Gazeta Shqiptare" nga Nikoll Pjetër Hysaj me banim në Michigan të SHBA-së, ku jeton si emigrant politik nga viti 1979, kur u arratis nga Shqipëria

# "Ju tregoj persekucionin e egër 45-vjeçar që iu bë Vermoshit nga regjimi komunist"

Nikoll Hysaj: "Zotërinj historianë, ju lutem, thoni të vërtetën për krimet e komunizmit që kanë ndodhur në Shqipëri. Ju zoti Pëllumb Xhufi, jeni historianë qorra të oborrit të vjetër"



Nga Nikoll  
Pjetër Hysaj

Jetoj prej 38 vjetësh në shtetin e Michiganit në USA. Në të kaluarën dhe aktualisht kam ndjekur dhe ndjek me vëmendje të gjitha zhvillimet politiko-ekonomike dhe shoqërore të trevave shqiptare. Para viteve 1990 emigrantët shqiptarë, veçanërisht në të larguarit nga Shqipëria për motive politike, kishin shumë vështirësi për t'u lidhur me familjet e të afërmit që kishin lenë në Atdehe. Këto vështirësi e të tjera vinin nga fakti i vetëizolimit dhe diktaturës që konsolidoi regjimi komunist në Shqipëri, jo vetëm me ne emigrantët dhe botën e jashtme, por edhe mes vetë shqiptarëve që jetonin në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni dhe Çamëri, akte antinjerëzore këto që i kanë sjellë dëme të pallogaritshme kombit shqiptar. Këto vështirësi e të tjera që na hasëm në jetën tonë të gjatë në emigracion, falë Zotit, përfunduan një herë e përgjithmonë në vitin 1990 me përmbyesjen e regjimit totalitar komunist në Shqipëri si dhe me zhvillimet në fushën teknologjike në krijimin e një bote globale, na kanë dhanë mundësi të ndjekim jetën reale që bëhet në të gjitha trevat ku jetojnë shqiptarët në Ballkan.

Kohët e fundit kam ndjekur me vëmendje debatet që janë realizuar nëpër studio televizive, shumë shkrime, prononcime, debate e komente që janë bërë në gazetata dhe portalet mediatike në Shqipëri për kampet e përqendrimit dhe veçanërisht të Tepelenës ku ka qenë e internuar për 5 vjet edhe nëna ime me familjen.

Vite të tëra kemi pritur që ju vetëm shteti shqiptar, partitë politike, shoqatat, historianët, shoqëria civile,

por edhe vetë persekutorët duhet të kishin reflektuar e të kontribuonin shumë vite më përpara për dokumentimin profesional të krimeve të kryera gjatë regjimit komunist, që të zënë vendin e merituar në Historinë e Shqipërisë, duke iu shërbyer brezave që do të vinë. Shpesh kjo temë nga media të ndryshme realizohet si show mediatik. Kështu tuneli duket si pa fund.

Me përmbyesjen e regjimit komunist dhe vendosjen e demokracisë në Shqipëri fituan të drejtat tona legjitime jo vetëm ne shtresat e të përndjekurve politike, por edhe persekutorët me trashëgimtarët e tyre, fituan të gjithë shqiptarët kudo që janë. Kështu demokracia i dha mundësinë përsëri edhe asaj shtrese të regjimit komunist që të jetë pjesë-marrëse aktive në të gjitha fushat e jetës së vendit. Ne, shtresa e të përndjekurve, megjithëse na persekutuan, na internuan, burgosën, pushkatuan e na vranë pa gjyq e pa qenë fajtorë, FALEM. Kur dëgjoj, shikoj dhe lexoj me veshët dhe sytë e mi; historianë, analistë, politikanë, gazetarë e veçanërisht ata që përfaqësojnë shtresën e ish-regjimit komunist, nuk më vjen mirë, jam i lënduar dhe nuk më besohet që për 28 vjet të mos kenë përfutur këta persona e kjo shtresë intelektuale e shoqërisë shqiptare, të paktën pak kulturë dhe shpirt demokratik që kur diskutojnë për krimet e diktaturës ndaj grave dhe femijëve të jenë më njerëzorë e minimalisht të thonë të vërtetën.

Jam shumë i shqetësuar pasi edhe pse po kalojnë gati 30 vjet nga përmbyesja e regjimit diktatorial, ne shtresave të përndjekurve politike nuk na kanë kërkuar institucionalisht falje për krimet që janë bërë ndaj nesh. Fatkeqësisht shtresat e të përndjekurve politike në Shqipëri janë keqpërdorur për interesa politike e partiake, ndaj edhe përfaqësuesit e klasës politike shqiptare, akoma nuk



Nikollë Hysa në Michigan

janë distancuar dhe nuk janë ndërgjegjësuar për krimet që regjimi diktatorial komunist i Enver Hoxhës ka bërë ndaj shtresave nacionaliste shqiptare. Kjo vërtetohet edhe nga fakti i mos dëmshpërlimit në kohë i të përndjekurve politike, të cilët qëllimisht politika shqiptare i mban të varur pas interesit të saj dhe veçanërisht papërgjegjshmëria se si flitet dhe se si trajtohen ato krimet në ditët e sotme që është edhe objekti i këtij shkrimi.

### PËLLUMB XHUFIT, DHE HISTORIANË QORRA TË OBORRIT TË VJETËR

Para disa muajve historiani i mirënjohur në Shqipëri z. Pëllumb Xhufi, në një emision televiziv, ndër të tjera është shprehur se është "banalitet" të krahasohet kampi i Tepelenës me kampet e përqendrimit të nazistëve. Edhe pse zoti Xhufi mbas viteve 1990-të është pozicionuar si politikan i së majtës shqiptare, unë vazhdimisht e kam ndjekur me vëmendje dhe respekt të veçantë në emisionet televizive, për sa i përket trajtimit të tematikave historike të fushës së tij, sidomos të figurës së Skënderbeut dhe të Nënë Terezës, si dhe gjenocidit e ushtrisë greke që ka bërë në Sh-



qipërinë Juglindore. Për këto shprehje z. Xhufi i kritikua në të gjitha mediat shqiptare. Në prononcimin e tij, mbas kritikave serioze që ju bënë, ai jo vetëm që nuk reflektoi e nuk kërkoi falje, për çka kishte thënë gabim, por përkundrazi mori rolin e avokatit të krimeve të komunizmit. Kjo tregon se z. Xhufi dhe historianët të tjerë shqiptarë, megjithëse të cilësuar si profesionistë, nuk shkëputen dot nga partitizmi e për rrjedhojë fatkeqësisht vetakuzohen si; "historianë qorra të oborrit të vjetër".

Për t'i dhënë një përgjigje vetëm me fakte zotit Xhufi dhe të tjerëve që mendojnë dhe gjykojnë si ai, unë para se t'i referohem familjes sime, Hysaj, dhe fshatit tim Vermoshit, do të falënderoj cilindo shqiptar

apo të huaj goftë që në çfarëdo mënyre apo forme respekton dhe kontribuon për ruajtjen e historisë së shtresave të të përndjekurve politike në Shqipëri. Kur është fjala për gjëra konkrete le të respektohen këto shtresa, të flasin vetë për vuajtjet dhe torturat së pari ata që i kanë hequr në kurrizin e tyre dhe për ata persona që nuk jetojnë më, i tregojmë ne, bijtë e tyre. Më pas, për të dhënë një tablo më të plotë të këtij persekutimi, le të shikohen arkivat, të flasin historianët, specialistët dhe studiuesit e këtyre fushave. Edhe pse këto janë krimet të kryera në kohën e komunizmit, janë me shumë vlera për historinë e kombit shqiptar, ndaj personat që duhet të merren me këto studime dhe dokumentime duhet të jenë seriozë, të sinqertë e të besueshëm ndaj kombit dhe të vërtetës pasi kur fliten gjera pa baza, jo të vërteta, është vrasje për herë të dytë.


Le t'i referohemi fakteve konkrete dhe lexuesit do ta kenë shumë më të lehtë për të gjykuar për krimet që regjimi komunist ka bërë në fshatin Vermosh si: pushkatimet, të burgosurit individualisht dhe me familje, të vdekur në internime e në kampin e Tepelenës duke mos llogaritur pasojat që sillnin këto persekutime në breza për këto shtresa.

### VERMOSHI, FSHATI IM NËN PERSEKUCIONIN KOMUNIST

Fshati Vermosh i Kelmendit në vitin 1945 kishte 76 shtëpi me popullsi mesatare përafërsisht 900 banorë.

### Informacione periodike gjatë periudhës 1945-1990

**Të pushkatuar:**  
1. Prek Cali Hasanaj, 2. Fran Mali Lekutanaj, 3. Dom Ded Macaj (prift), 4. Dod Prek Bujaj, 5. Marash Vata Lumaj, 6. Pjeter Gjeka Hysaj, 7. Nik Marku Rexhaj, 8. Gjon Preci Rexhaj (25 vjeç ishte kur u pushkatua), 9. Ded Lulash Smajlal, 10. Pllum Nikolla Pllumaj (17 vjeç



kur u pushkatua në 1990-ën), 11. Gjergj Ndua Vuçaj (ishte 22 vjeç kur u pushkatua).

### Të burgosur politikë:

1. Dodë Biniku Pllumaj (vdes në burg), 2. Nikoll Dod Pllumaj (i dënuar dy herë nga 7 vjet), 3. Zef Kola Hysaj, 4. Gjëllosh Kola Hysaj, 5. Gjon Kola Hysaj, 6. Fran Gjoni Lelçaj, 7. Gjergj Gjeto Vushaj, 8. Ndue Luca Vukaj, 9. Fran Ndue Vukaj, 10. Luc Pashku Vukaj (vdes në burg), 11. Ded Pjeteri Vukaj, 12. Gjon Lleshi Peraj, 13. Nikoll Pjeteri Tinaj, 14. Tom Marku Lumaj, 15. Gjergj Jaku Shqutaj, 16. Mark Zef Smajlal, 18. Vat Gjon Smail, 19. Zef Gjeto Volaj, 20. Nik Gjoni Vuktilaj, 21. Dod Prek Bujaj, 22. Gjëllosh Dod Bujaj, 23. Fran Zef Vushaj, 24. Palok Nik Shqutaj, 25. Fran Llesh Tinaj, 26. Dod Gjon Bujaj (një vit hetuesi).

### Gra e vajza të dënuara:

27. Dike Martin Tinaj (4 vjet burg), 28. Mri Zef Rexhaj (16 vjet burg), 29. Lule Zef Hysaj (6 muaj burg, ishte shtatëzëne dhe e liruuan).

### Familje të internuara:

1. Pashko Nik Lekoçi, 2. Prek Noshi Lekutanaj, 3. Vat Mali Lekutanaj, 4. Ded Nikoll Vushaj, 5. Nikoll Gjeto Preloci Tinaj, 6. Tom Zef Tinaj, 7. Mark Zef Tinaj, 8. Gjergj Llesh Tinaj, 9. Palok Luca Vukaj, 10. Pashko Luca Vukaj, 11. Gjergj Ndue Luçaj Vukaj, 12. Agostin Mark Tinaj, 13. Gjergj Gjeto Vushaj, 14. Prel Gjeto Vushaj, 15. Dod Binaku Pllumaj, 16. Zef Binaku Pllumaj, 17. Tom Zef Vushaj, 18. Fran Zef Vushaj, 19. Kol Nik Hysaj, 20. Pjeter Gjek Hysaj, 21. Fran Mirak Lumaj, 22. Tom Kola Pepaj, 23. Nok Uca Volaj, 24. Zef Baci Mitaj, 25. Nikoll Prek Malaj, 26. Fran Zef Deda-Volaj, 27. Fran Zef Vuktilaj, 28. Mark Zef Vuktilaj, 29. Nik Mark Rexhaj, 30. Prek Mark Rexhaj, 31. Noc Ded Lumaj, 32. Fran Zef Vukaj, 33. Gjon Kol Hysaj, 34. Gjëllosh Kol Hysaj, 35. Vasel Marku Lumaj, 36. Llesh Prek Rexhaj (2 herë internuar), 37. Ndue Prek Rexhaj (1948-1990), 38. Pren Luçaj Gjergj (1948-1990), 39. Pashk Gjergj Pllumaj, 40. Familja e Nikoll Gjetos Perlocit është internuar 2 herë.

Ndërsa familja ime (Nikoll Pjetër Hysaj), përbëhet nga 9 veta të internuar në





kampin e Tepelenës dhe konkretisht: Gjelojsh Kol Hysaj, Mare Nika Hysaj, Pren Martini Hysaj, Gjergj Pjeter Hysaj, Age Gjon Hysaj, Katerin Pjeter Hysaj, Lule Kolë Hysaj, Mare Gjergj Hysaj, Luigj Gjergji Hysaj.

Të vdekur në kampin e internimit Tepelenë:

- 1.Djali Mark Pashkut, Lekutonaj, 2.Djali i Fran Zef Vuktilaj, 3.Vajza e Tom Zef Tinaj, 4.Djali i Mark Zefi Tinaj, 5.Gruaja e Gjergj Lul Tomes-Hysaj, (Siç tregojnë të ata që kanë vuajtur bashkë me të, kjo zonjë ishte e vdekur dhe djali i saj, Luigji, vazhdonte të pinte gjirin e saj të shterur), 5.Zef Binak Pllumaj, 6.Pren Luc Pllumaj, 7.Pashk Gjergj Pllumaj, 8.Pashko Ndue Vukaj, 9.Fran Zef Vuktilaj.

Të vdekur në burg:

- 1.Dod Binaku Pllumaj, 2.Luc Pashko Vukaj. Familje të titulluara kullake: 1.Nua Preka Selmanaj,2. Mark Zefi Lumaj. Shtëpi të sekuestruara nga shqiptarë: Shtëpia e Prek Calit nga viti 1948 deri më 1990, shtëpia e Mark Pashkut nga viti 1948 deri më 1970, shtëpia e Çun Nishkut, Pjeter Gjeka Hysaj, Dod Marashi Hysaj ja u mori shteti për 8 vjet, shtëpinë e Mark Zef Lumaj për 4 vjet, shtëpia e Gjergj Jaku Shqutaj, për 8 vjet, shtëpia e Mark dhe Toma Zef Prelocit për 2 vjet, dhe shtëpia e Prec Marku Rexhaj për 2 vjet. Po ashtu më shumë se 15 shtëpi me detyrin duhet të lironin nga një ose 2 dhoma për oficerët e postës kufitare ose për mësuesit dhe infermierët pa asnjë pagesë deri në vitin 1960.

Të arratisur politikë jashtë shtetit, kryesisht në grupe:

- 1.Pashko Nike Lektutanaj, 2.Mark Pashko Lektutanaj, 3.Pjeter Noshi Lektutanaj, 4.Gjergj Noshi Lektutanaj, 5.Leze Pjeter Lektutanaj, 6.Dod Binku Pllumaj, 7.Zef Binku Pllumaj, 8.Nikoll Dod Pllumaj, 9.Nikoll Pjeteri Malaj, 10.Ded Nikolla Vushaj, 11.Gjergj Gjeta Vushaj, 12.Zef Gjergji Vushaj, 13.Dod Zefi Vushaj, 14.Gjovalin Zef Vushaj, 15.Kanto Zef Vushaj, 16.Sokol Zef Vushaj, 17.Kole Zef Vushaj, 18.Lume Zef Vushaj, 19.Vladimir Zef Vushaj, 20.Len Fran Vushaj,



21.Katrine Zef Vushaj, 22.Drite Zef Vushaj, 23.Ded Nikolle Vushaj, 24.Dielle Pashko Vushaj, 25.Shaqe Ded Vushaj. Arratisja e familjes së Zef Gjergj Vushaj me 12 vetë në vitin 1987 tronditi nga themelet piramidën e shtetit komunist shqiptar që nga Byroja Politike deri tek ushtri më i thjeshtë. Arratisja e kësaj familjeje jo vetëm që realizoi qëllimin e saj për të fituar lirinë dhe të drejtat që u mungonin, por ishte edhe një mesazh trokitje se fundi i atij regjimi ishte i afërt. 26. Mark Pashko Lelçaj (me 4 pjesëtarë të familjes së tij), 27.Gjelojsh Gjok Lelçaj, 28.Nikollë Gjeta Tinaj, 29.Fran Gjeta Tinaj, 30.Ndue Gjeta Tinaj, 31.Pjeter Ndue Tinaj, 32.Rrok Ndue Tinaj, 33.Tom Zef Tinaj, 34.Mark Zef Tinaj, 37.Palok Luc Vukaj, 38.Gjok Palok Vukaj, 39.Marash Palok Vukaj, 40.Tom Gjergj Vukaj, 41.Luigj Pashko Vukaj, 42.Lazër Fran Vukaj, 43.Vat Mali Lektutanaj, 44.Pjeter Vata Lektutanaj, 45.Nika Vata Lektutanaj, 46.Tom Zef Vushaj, 47.Fran Zefi Vushaj, 48.Nikoll Tom Pepaj me bashkëshorten Milevën dhe vajzën Hana, 51.Gjelojsh Toma Pepaj, 52.Kole Nika Hysaj, 53.Pjeter Gjeka Hysaj, 54.Mark Gjeka Hysaj, 55.Gjon Kola Hysaj, 56.Nua Kola Hysaj, 57.Prel Kola Hysaj, 58.Pren Martin Hysaj, 59.Tom Gjergj Hysaj, 60.Sander Gjergj Hysaj, 61.Luigj Gjergj Hysaj, 62.Nikollë Pjeteri Hysaj, 63.Fran Miraka Lumaj, 64.Mark Fran Lumaj me bashkëshorten Julkën, 67.Zef Bacit Mitaj, 68.Nok Uca Volaj, 69.Fran

Zefi Ded Volaj, 70.Fran Zefi Vuktilaj, 71.Mark Zefi Vuktilaj, 72.Nikoll Fran Vuktilaj, 73.Dod Nikolla Vuktilaj, 74.Prec Marku Rexhaj, 75.Pjeter Preci Rexhaj, 76.Gjergj Nika Rexhaj me gruan Maria dhe 3 djemtë dhe nëna Age Zef Rexhaj, 70 vjeç, 82.Gjergj Fran Tinaj, 83.Lize Pjeter Tinaj, 84.Plum Gjergj Tinaj, 85.Vat Gjergj Tinaj, 86.Ervin Gjergj Tinaj, 87.Petrit Dod Tinaj, 88.Rrok Pjeter Vushaj,89. Vera Rrok Vushaj.

HISTORIA E FAMILJES SIME HYSAJ, NË REGJIMIN KOMUNIST

Mbas viteve 1945, sidomos ngjarja e zhvillimit të luftës antikomuniste në Tamarë, vrasja e shumë bashkatdhetarëve, asgjësimi i Prek Calit dhe veçanërisht hyrja e partizanëve me flamurin shqiptar dhe serbo-malazez me të cilët jemi vranë për qindra vjet, acaroi shumë marrëdhëniet e kësaj zone me Partinë Komuniste në pushtet, e për rrjedhojë shumë bashkatdhetarëve ju rrezikoheshin jeta. Kjo trysni si dhe shantazhe të tjera të organizuara nga regjimi komunist bënë që në muajt shtator-tetor 1948, të lenë familjet, pasuritë dhe gjithçka e të arratiseshin kolektivisht për në Jugosllavi 46 bashkëfshatarë nga Vermoshi. Me këtë grup u arratis edhe babai im, Pjeter Gjeka Hysaj. Një muaj mbas arratisjes së babait, familjen time e internuan në kampin e Tepelenës. Familja ime përbëhej nga 8 veta. Mare Nika Hysaj, Pren Martini Hysaj, Gjergj Pjeter Hysaj, Age Gjon Hysaj, Katerin Pjeter Hysaj, Lule Kole Hysaj, Mare Gjergj Hysaj, Luigj Gjergji Hysaj dhe Gjelojsh Kole Hysaj. Sipas tregimit të nënës sime dhe të bashkëfshatarëve të tjerë, banorët e fshatit Vermosh të caktuar për internim i mblodhën tek posta kufitare që ndodhej në shtëpinë e Prek Calit dhe i nisën të shkuar deri tek Hani i Hotit. Rruga ishte shumë e vështirë jo vetëm për distancën 74km. larg nga Vermoshi që duheshin tre ditë udhëtimi, por edhe për faktin se gati të gjithë kishin femijë të vegjël, në moshë të mitur, të sëmurë, gra shtazëna e pleq të moshuar. Furia e diktatorit komuniste s'kishte të ndalur, as ligj dhe as mëshirë. Femijët e vegjël që nuk ecnin dot në këmbë i ngarkuan me kofina e djepa në disa mushka që i shogëronin të internuarit. Këtë fat pata edhe unë si pjesëtar i familjes Hysaj. Isha vetëm 1 vit e 3 muaj, e pa mundur të ecja në këmbë dhe më ngarkuan si gjithë femijët e tjerë, me gjithë djep, në një mushkë e cila më ndryshoi fatin e jetës sime, për të mos shkuar në internim. Gjatë rrugës mushka u tremb dhe duke dalë jashtë rruge, më rrezoi mua me gjithë djep në tokë. Jeta m'u u në rrezik, por falë Zotit, sipas tregimit të personave që ishin aty, shpëtova për mrekullim. Kur nëna ime e pa se çfarë ndodhi, me vrap erdhi të më merrte me vete, por oficerët që e shoqëronin nuk e lanë. Kështu më morën disa bashkëfshatarë që nuk u internuan dhe për tre muajt janë interesuar për mua duke më



mbajtur shtëpi më shtëpi gjatë kësaj kohe në fshatin Vermosh. Personat dhe familjet që më ndihmuan në këto momente vuajtje, edhe pse një pjesë e tyre nuk jetojnë, gjë rastin t'i falënderoj nga zemra për dashurinë familjare që më falën. Pastre muajve më mori nënë daja, gjyshi nga mamaja ime, e cila jetonte në fshatin Shkrel.

SI E VRANË KUFITARËT BABANË TIM DHE I KEQTRAJTUAN KUFOMËN

Gjatë kohës që familja ime ishte në internim, babai im me dy tre shokë të tjerë që ishin arratisur së bashku, më 17 shtator të vitit 1952, erdhi në fshatin Vermosh që të merrnin me vete dy djemtë e Marash Vata Lumaj të cilin në vitin 1946 shteti shqiptar e kishte pushkatuar para popullit në fshatin Vermosh pa gjyq dhe pa arsye. I vetmi gabim i tij ishte, vetëm se ishte atdhetar; i pashëm dhe i pasur. Forcat e kufirit të shtetit shqiptar e vranë babain tim, Pjeterin, kur ai kishte hyrë në fshatin e tij Vermosh. Eshhtë e dhimbshme kur bashkëfshatarët e mi tregojnë se ushtarët dhe oficerët e kufirit, jo vetëm që e vranë, por edhe e keqtrajtuar kufomën e tij mbas vdekjes. Zoti i faltë kur vëllezërit e tu nuk dinë çfarë bëjnë. Persekutimi vazhdoi dhe pse një pjesë e familjes sime u lirua nga internimi. Nënë e mbajtën atje, në kampin e përqendrimit të Tepelenës, duke provuar vuajtjet me mizore që ka parë historia. Pyes veten shpesh se çfarë rreziku do t'i sillte nëna ime, Age, pushtetit komunist?! Kur mendoj se bashkë të më kanë qenë me mijëra nëna e fëmijë, pleq e plaka, turpi le t'i ngelet atij regjimi diktatorial, të pa-shoq. Vitet kaluan dhe mbas 5 vjetësh nëna u lirua nga internimi dhe duke udhëtuar për ditë të tëra në këmbë vjen në shtëpinë e saj në Vermosh.

SI E TAKOVA NËNËN TIME PËR HERË TË PARË KUR ISHA 6 VJEÇ

Më kujtohet si sot takimi im i parë me nënën kur atëherë isha 6 vjeç e gjysmë. Ishte pasditë. Unë ndodhesha para shtëpisë sime dhe

shokët duke luajtur. Ajo u afrua, kishte me vete një çantë dhe me pyeti se i kujt isha. Unë menjëherë i thashë se; jam i nënë dajës. Më rroku me shpejtësi, më përqafoi, më puthi me mall, më shtrëngoi fort-fort dhe qau...Edhe nënë daja me rrokte për ditë kështu, por këtë rrokje të nënës sime s'e kisha provuar asnjëherë. Më mbajti për një kohë të gjatë në gj dhe mbasi u qetësua, fshiu lotët që i kishin mbuluar fytyrën e saj, hapi çantën dhe nxori prej andej një karamelë të cilën se kam harruar tërë jetën. Kështu femijëria ime, kur kisha më shumë se kurrë nevojë, lundroi pa e parë Nënë për pesë vjet dhe jetim nga babai të cilin se pashë asnjëherë në jetën time.

VUAJZET E NËNËS SIME NË KAMPIN E TEPELENËS

Kur u rrita, dëgjoja bashkëfshatarët e mi që bisedonin për vështirësitë që kishin kaluar familjet e tyre në kampin e Tepelenës dhe unë bëhesha shumë kurioz, ndaj disa herë e kam pyetur dhe nënën time e cila gjithmonë më tregonte ngjarje dhe ndodhi të dhimbshme, më tregonte se në kamp edhe ajo me pjesëtarët e tjerë të familjes kishin vuajtur shumë, kryesisht për të ngrënë. Shumë herë flinin pa ngrënë bukë e kur nuk kishin ushqime të mjaftueshme, hanin kripë më shumë që të kishin etje dhe ta mbushnin barkun me ujë. Gati çdo ditë oficerët i çonin për të mblledhur dru jashtë kampit, ngarkoheshin dhe isllinin ato në kurriz. Kampi nuk kishte as kushte dhe as interesim më të vogël për femijët që ndodheshin aty. Ishin të shumta rastet kur femijët, gratë dhe nënë përgjithësi të moshuarit, vdisnin në grupe nga sëmundjet epidemike, por edhe raste të veçanta që janë rrëqethur. Nuk kishte fare kujdes shëndetësor nga shteti. Të sëmurët coheshin në spital kur ishin gati për të vdekur.

JA KËSHTU, TREGON NENA, NDODHI ME MARE HYSAJ.

Në kampin e Tepelenës, Luigji i vogël, fjeti deri në mëngjes me nënë e vdekur... Ishte darkë, Luigji (sot jeton në Ulqin-Mal i Zi) po qante me të madhe. Pushonte dhe qante përsëri. Kësh-

tu vazhdoi për një kohë të gjatë. Unë, tregon nëna, i thirra; Mare, moj Mare, çfarë ka djali që po qan kaq shumë, por Mara nuk përgjigjej. Atëherë unë shkova tek krevati i saj dhe çfarë të shihja, Mara mor bir, tregon nëna, kishte vdekur me femijën në gj, i cili qante se nuk kishte qumësht. Lotët nuk i pushonin sa herë që nëna e tregonte këtë ngjarje, pasi edhe Luigji nëse nuk do të qante, do të kishte pësuar fatin e nënës së tij atë natë. Një ditë, më tregonte nëna, erdhi një ekip i Ministrisë së Punëve të Brendshme, dy oficerë rusë. Rrok Kanti me shokët e tij organizuan një grup me femijët që ishin në kamp të internuar dhe i kishte përgatitur ata që në korr të bërtisnin: "Enver-Stalin, pionierët duan lirim". Nga thirrjet e korit, që ofshëtinin dhe tundën nga themelet kampin, oficerët rusë u prekën e u përleton kur i panë me pantallonë e bluza të grisura, të pa veshur, të pa mbathur në kushte shumë të vështira. Kjo vizitë dhe ky guxim i organizuar nga të internuarit bëri që mbas një muaji të gjithë femijët që ishin në kamp të liroheshin nga internimi. Edhe vëllezërit dhe motrat e mia; Gjelojshi, Gjergji, Katerina dhe Lula dhe dy gra të vjetra, Mara dhe Prenu u liruan nga kampi i internimit. Nëna ime ngeli në internim deri në vitin 1953 në kampin e Tepelenës. Mbas kthimit të nënës nga internimi, familja jonë filloi të rindërtojë jetën nga e para, por pushtakrimi i babait dhe internimi i familjes gjithmonë na kanë ndjekur pas si një hijë zezë si gjithë shtresat e tjera të persektuara. Këto ishin edhe arsytet përse unë në vitin 1979 lashë familjen e u arratisa nga Shqipëria duke marrë parasysh edhe vdekjen, ku nëpërmjet një udhëtimi të vështirë dhe të gjatë, munda të mbërrij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku jetoj aktualisht. Mbas viteve 1990 e në vazhdim, kam mbajtur dhe mbaj marrëdhënie shumë të forta me atdheun tonë, Shqipëri. Si gjithë të tjerët kemi fituar shumë; lirinë, demokracinë, dinjitetin, etj., por jo ato që i kemi humbur nën regjimin komunist. Faktet qëolla nëpërmjet këtij shkrimi duke ju referuar persektimit që regjimi komunist ka bërë jo vetëm në fshatin Vermosh të Kelmendit, mendoj se janë të kuptueshme për të gjithë njerëzit që kanë jetuar sistemin komunist në Shqipëri. Ndërsa për brezat e rinj, njohja me ato krime historike të rëndësishme e historianeve, gazetarëve e veçanërisht e shtetit shqiptar që t'i dokumentojnë këto krime bazuar në prova dhe fakte të vërteta të padiskutueshme në mënyrë profesionale e të kuptueshme me qëllim që të rinjtë nëpërmjet kësaj historie të mësojnë të vërtetën mbi këto krime në mënyrë që ato kurrë të mos përsëriten më.

(Nikoll Pjeter Hysaj, Michigan, 28 gusht 2018)

Opinion i Ditës

# 10 vjet nga kriza financiare, pyetjet mbeten pezull ...!

Nga Përparim KABO

(vijon nga faqja 1)

... dhe kontrollojnë jetën ekonomike dhe atë të parasë, por që gati rrëzoi (nga vetvetja) vetë sistemin kapitalist, i cili në kushtet e imperialitetit të tregut dhe globalizimit financiar në një proces spiral krijoi krizën e deflacionit. Investimet e kredituara u ngurtësuan. Individë dhe banka nuk kishin më likuiditete dhe nuk kthenin dot kreditimet. Borxhet u ngritën si cunamë... Njerëzimi u ndesh me një krizë ndryshe nga ajo e viteve 30-të të shekullit XX, e cila ishte e tregtisë, e mallrave, kurse kjo e 2008-s e parasë...! Magjistari hyri në krizë! Paraja vetëvritet. Njerëzit humbën busullën, shoqëria globale u godit rëndë. Tronditja njerëzore përshfaqi pamje të dhimbshme. Humbje kursimesh deri tek pensionistët. Prej disa ditësh ekspertët e fushës, rubrikat media-tike të specializuara në mediat botërore si BBC, CNN etj., me gjuhën e shifrave dhe fakteve, janë përqendruar tek problematikat e krizës, me argumentin kyç: Kriza ka kaluar apo jo përfundimisht? Dhe pyetjet pezull janë: Shoqëria paskrizë ka mbetur me pasoja apo ajo është krejtësisht e përballuar dhe e tejkaluar tashmë? A dolën nga kriza disa vende që e pësuan edhe më shumë për shkak të borxhit të jashtëm? Është shëndosur gjendja në institucionet financiare dhe monetare në të gjithë spiralen, dhe a funksionon rregullisht BOT (Building Operation Transfer) (operacioni i transferimit të parave në nivele me qëllim gjallërimin e ekonomisë). A ishte vetëm një aksident i nevojshëm ndërhyrja e shtetit me paratë publike për të shpëtuar në mënyrë selektive disa nga bankat dhe lënia të falimentonin i disa të tjerave? A është ekonomia e tregut një lojë ekuilibri dhe disekuilibri që gjen dhe humbet balancat në mënyrë spontane? Apo ajo që ndodhi ndryshoi kuptimin mbi ekonominë në tërësi dhe ridimensionoi marrëdhëniet mes shtetit dhe tregut në shekullin XXI?... Orientimi i individit duhet të bëhet kah publikë dhe demokracisë, apo kah private dhe tregut? Bota shkon drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe të kontrolluar e drejtuar në të gjithë kontinentet, apo kriza vijon në ndeshjen për tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ajo që quhet "tregtia e lirë" është shndërruar tashmë në një "luftë të ftohtë të tregjeve". Mbase Organizata Botërore e Tregtisë po njeh dështimin në misionin e saj. Pas 10 vjetësh nga viti 2008, përgjatë krizës dhe jeta politike globale ka njohur ndryshime



të thella. Pas largimit të Bushit të ri dhe 8 viteve të Barak Obamës si president i SHBA-ve, i cili e menaxhoi me urtësi krizën; për herë të parë në Shtëpinë e Bardhë kemi një personalitet që vjen nga fusha e biznesit. Pavarësisht nga paqëndrueshmëria në politikat globale dhe provokimet hera e herës tejet të guximshme që kanë pështjelluar kancelaritetë jo pak, është fakt që gjenden ekonomike në SHBA ai e ndryshoi, duke arritur me një papunësi fare të ulët. Punohet fort për rregullim bilancesh tregtare, kundra ekonomive që punojnë në mënyrë mbrojtëse, të mbyllura për importet dhe të hapura për eksportet (Kina, Japonia)... Britania e Madhe fal Brexit e la Bashkimin Europian. Vendet e Vishegratit, me në krye Hungarinë i thanë ndal hapjes së dyerve për emigrantët e fesë myslimane. Më në fund dhe Italia e ngriti zërin dhe po i tregon BE-s, se si qeveri italiane ajo duhet të kujdeset fillimisht për Italinë... Mendohet dhe komentohet, se është e gabuar deklarata e zotit Trump: "Amerika e para". Në fakt, është sqaruar se kjo thënie, nuk ka kuptimin "Amerika vetëm". Pse habiten dhe e sulmojnë këtë deklaram. Edhe Gjermania ashtu vepron, me moton Gjermania e Para. Franca po ashtu, Makron sa erdhi në pushtet ushtroi presion te Kancelarja gjermane Merkel për politika ndryshe financiare tatimore dhe monetare, me qëllim shëndoshjen e financave të Francës. Si edhe shkruante revista "The Economist" (June 17-23 2017) në editorialin me titullin provokues: "Europe's Saviour?" (Shpëtimtari i Europës)- shprehjet për presidentin e ri francez: "Zoti Makron ka bindur disi francezët se përparimi është i mundur. Ai u kthye sërish kundër sulmeve populiste se tregu i lirë është një koncesion ndaj bankierëve dhe global-

istëve, qoftë me rifreskimin e patriotizmit-qoftë duke i thyer dorën e Donald-it, ose duke restauruar madhësinë e presidencës." Edhe fuqitë e tjera të mëdha në gjeopolitikën dhe tregun global si Kina, Japonia, apo Britania e Madhe, pa dyshim të parin konsiderojnë veten. Me krizën janë marrë shumë autorë. Së fundmi Nobelisti Joseph Stiglitz në librin e tij titulluar "Busulla jo precize"- Etika në botën e financave të globalizuara... e sheh dhe e analizon krizën, ecurinë, kuptimin, gjykimin dhe daljen prej saj; edhe në aspektin etik. Në digression Ai të kujton Weberin dhe veberizmin si filozofia dhe sociologia protestante që vinte në qendër dinjitetin njerëzor: Stiglitz e fut etikën si element ekuilibri në botën dhe proceset e globalizimit. Përball "religjionit" të sotëm që quhet fondamentalizmi i tregut, Stiglitz si një Shën Agustini modern krijon strukturën mikse "ekonomia-etika". Asgjë nuk mund të lihet në verbërinë e ndeshjeve spontane. Ata që e krijuan krizën nuk mund të fshihen, nuk mund të shfaqësohen. Si edhe shkruan Stiglitz në librin e tij... "Ekonoministët, në veçanti ata pranë Departamentit të Thezarit të SHBA-ve dhe ata të Fondit Monetar Ndërkombëtar, prej kohësh i kanë tejkaluar kufijtë." Një shembull gjithbinës, por edhe tronditës ishte ai i Argentinës. Midis kombeve perëndimorë në epokën moderne, ndoshta vetëm Greqia mundi t'i rivalizonte trazirat ekonomike që Argjentina ka përjetuar. Kriza argjentinase ka qenë tejet e njohur që nga paniku i madh financiar i vitit 1976. Kriza më e re filloi në vitin 2000, megjithëse themeli filloi të shkrëmoqet që në fillim të vitit 1998. Krizat e viteve 2001-2002 kombinuan një krizë të monedhës dhe një panik financiar. Një monedhë e pa-suksesshme ndaj monedhës së

fortë dollarit amerikan, ia la peshën Argjentinës duke krijuar një rrëmujë financiare-ekonomike dhe sociale. Depozituesit e bankave u panikuan kur qeveria argjentinase flirtohte me një ngrirje të depozitave, duke shkaktuar rënie të ndjeshme të normave të interesit. Më 1 dhjetor 2001, ministri i Ekonomisë i asaj kohe, Domingo Cavallo miratoi një ngrirje të depozitave bankare. Familjeve u bllokuan kursimet e tyre dhe normat e inflacionit goditën duke kapur nivel astronomik prej 5.000%. Brenda javës, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) njoftoi se nuk do të ofronte më mbështetje për Argjentinën. Vendi ishte tashmë një shpërdorues/ apo i shpërdoruar serial dhe si përfundim autoritetet ndërkombëtare nuk besuan se reformat e duhura do të zhvilloheshin atje. Qeveria argjentinase humbi hyrjen në tregjet e kapitalit, dhe institucionet financiare argjentinase private e ndërprejnë gjithashtu aktivitetin. Shumë biznese u mbyllën. Bankat e huaja - me një prani të madhe deri në atë kohë - u tërhoqën në masë. Kishin gjykuar më mirë kështu sesa të rrezikonin pasuritë e tyre. Natyra e çrregullit dhe ekstreme e normave të interesit e bëri praktikisht të pamundur për çdo firmë financiare të funksiononte siç duhet.

A erdhi kriza papritur?

A nuk shiheshin financimet e mëdha të bankave dhe rreziku moskthimit të tyre? Nuk mund të pranohet një arsytim i tillë shfaqësues. Sot pas 10 vitesh le të kujtojmë në vija të përgjithshme se çfarë ndodhi. Në vitet 2007-2009 ajo pllakosi. Kriza Globale Financiare duhet konsideruar gjerësisht si kriza më e madhe ekonomike globale që nga Depresioni i Madh. Si krizë globale financiare ajo nisi në 2007-2009 në SHBA dhe u përhap në pjesën më të madhe të botës së zhvilluar. Mjaft është shkruar për

natyrën dhe shkaqet e Recesionit të Madh, por tregimet thelbësore përqendrohen rreth bankave kryesore të investimeve që mbivendosen me përdorimin e letrave me vlerë të mbështetura nga hipotekat. Kthimet dhe cmimet e instrumenteve MBS të bankave u bazuan në rritjen e çmimeve të banesave të shkaktuara nga një fluskë asetesh e paqëndrueshme në tregun e shtëpive në SHBA. Më tej rënia e çmimeve të banesave, krijoi një reaksion zinxhir të dështimit nga lëshuesit e bonove në të gjithë vendin, duke filluar në hipotekat dhe përfundimisht duke u përhapur në të gjithë tregun mbarë të MBS. Për fat të keq për bankat ndërkombëtare të investimeve, i gjithë sistemi financiar botëror ishte rritur gjithnjë e më shumë në vitet 1990 dhe në fillim të viteve 2000. Pa kontroll serioz ishin lëshuar letra me vlerë të mbështetura nga hipotekat me normë të rregullueshme - shumë prej të cilave në mënyrë të pashpjegueshme kanë marrë vlerësim AAA nga Moody's dhe Standard & Poor's -. Ato depërtaun në portofollet japoneze dhe europiane të investitorëve. Fazat e hershme të krizës filluan në gjysmën e dytë të vitit 2007, duke shënuar kulmin në shtator të vitit 2008. Disa banka globale të investimeve u komprometuan keqas, duke përfshirë si të tilla buzë humnere, Lehman Brothers, AIG, Bear Stearns, Countrywide Financial, Wachovia dhe Washington Mutual. Kishte dështime të shumta të bankave në Europë, madje edhe në vendet që nuk duhet të ishin në krizë por që ende qenë të prekura falë aleancës ekonomike me BE-n. Më e keqja e recesionit të SHBA ka ndodhur në fund të vitit 2008, në fillim të vitit 2009. U dëshën disa muaj që paniku të godiste edhe Europën. Vende të tilla si Greqia, Irlanda dhe Portugalia, u tronditën më së shumti. Greqia vetëm tani së fundmi u çlirua nga kontrolli i Trojkës monetare dhe rifitoi të drejtën e sovranitetit mbi financat e veta publike. Efekti i krizës financiare globale mund të përmbledhet në statistikat vijuese: Në vitin 2009, prodhimi i brendshëm bruto global (GDP) u tkurr nga 63.07 trilion dollarë në 59.78 trilion dollarë. Kriza financiare kapi edhe Rusinë. Ekonomia ruse e udhëhequr nga Vladimir Putin u rrit ndjeshëm në vitet e para të shekullit 21, në pjesën më të madhe, falë sektorit energjetik të lulëzuar si dhe rritjes së çmimeve të mallrave në tregjet globale. Veçse ekonomia ruse u bërë aq e varur nga eksportet e energjisë aq sa që putohauë gjysma e të ardhurave të buxhetit u gjeneruan nga shitja e naftës dhe gazit natyror. Duke filluar nga qershori i vitit 2014, çmi-



Opinioni *i* Ditës

Nga Xhoi Jakaj\*


A ka "gjeni" në botë që lindin të tillë dhe truri tyre funksionon pa librin, studimet dhe të ushtruarit e të lexuarit?! Deri në 98% e veprimtarisë së trurit ndodh në mënyrë të pavetëdijshme. Disa gjëra që duket sikur nuk i dimë, në të vërtetë "fleenë" në mendjen tonë, por që veprimtaria e trurit të jetë në funksion të njeriut ai duhet mësuar me ushtrime ashtu sikurse dhe trupi ynë, dhe ushtrimet e trurit janë librat e të lexuarit. Gjenitë lindin një në një mijë, kurse një mijë mendje të tjera njerëzore pasi lindin zhvillohen nëpërmes të lexuarit.... Të harxhosh kohë duke iu përkushtuar leximit është një aktivitet për të cilin do falënderosh veten më vonë. Asnjëherë mos u justifikoni me elementin kohe për të mos i dedikuar ca minuta ose orë të lexuarit. Dhe sikur të reduktohet një konsum të njëjës kafe që pi gjatë përditshmërisë tënde për të lexuar, e sigurove leximin pa shumë mundime as shpenzim të kohës tënde produktive për punë. Përfitimet që grumbullohen janë të panumërta dhe ky shkrim shërben si një kujtesë në gjitha aspektet pozitive të cilat vlejnd dhe si një thirrjeje për të marrë sa më shpejt e mundësisht librin që ke lënë përgjysmë prej kohës ose nuk e ke nisur akoma ?!

1-Dijet asnjëherë nuk janë të tepërta. Funksioni i parë i librave është ai informues. Secili duhet të zgjedhë mes larmisë së titujve, atë që i duket më i përshtatshëm dhe që i shërben më formimin e tij akademik apo atë që përmbush kuriozitetet e tij dhe i sjell në mendje të shkuarën, adoleshencën, rininë apo mbas dhe projekton të ardhmen. Libri është një oqean dijeshe, prej të cilit nuk mbytesh por ririfkohesh, gjithashtu, mëson të përfeksionohesh stilin tënd të folurit dhe të përditshmërisë, fiton një lloj sigurie që ta jep gjithnjë të lexuarit, kjo është dije e pafundme që të jep dhe liri individuale.

2-Një fjalor i pasur dhe një artikullim i rrjedhshëm të bëjnë të ndjehesh krenar me veten gjithnjë.

Sa herë je gjendur në një situatë të vështirë, ku problemi më i

# Truri dhe dija



madh është të artikuloarit? Jam e bindur që përgjigja e të gjithëve ne është "Shumë herë." . Situatat e sikletshme, intervistat e punës, prezantimet përpara një grupi të madh njerëzish, e shumë raste të ngjashme bllokohen funksionin normal mendor dhe të folurit dhe kjo prej stresit dhe ankthit që krijohet, por leximi ndryshon gjithçka. Asnjë situatë nuk e gjen të papërgatitur dikë që i ka dedikuar shumë kohë leximit. Pasurimi i fjalorit të përditshëm, eliminimi i çdo huazimi, i cili aq sa e zgjeron edhe e vret gjuhën shqipe, por mbi të gjitha zhërvjellësia që të fal leximi, të bën që në çdo situatë të dalësh fagëbardhë. Afësitë e mira shprehëse gjithmonë ndërtohen prej leximit, dhe ndihmojnë njëkohësisht në aftësitë e shkruar, të cilave për shkak të elektronikës së zhvilluar nuk i vihet më shumë rëndësi.

3-Leximi freskon trurin dhe qelizat e kujtesës.

Konstatimi i mësipërm nuk është aspak i guditshëm. Një nga aktivitetet që ndihmon kujtesën tuaj është pikërisht leximi. Shkencëtarët, biologët dhe gjencencientët kanë vërtetuar se infor-

macioni i marrë nëpërmjet leximit është 5 herë më i rrënjosur në memoririn tuaj dhe më i përdorshëm prej jush, sesa informacioni i marrë nga mediat audiovizive. Nëse dëshironi që kujtesa juaj të jetë e pagabueshme deri në fund të jetës, kushtoni leximit minimalisht një orë në ditë. Justifikimet kur bëhet fjalë për leximin janë të papranueshme sepse kohë për të lexuar 30-60 minuta në ditë gjendet gjithnjë.

4-Leximi ul nivelin e stresit dhe rrit përqendrimin. Stresi duket se është fjala më e përdorur në përditshmërinë tonë. Në punë hasemi me të, në shkollë shtohet shpesh fjala jam në stres, madje edhe në pritje të operacioneve të përditshme në institucione bankare apo shtetërore ndjen stresin dhe padurimin. Kundër të gjithë këtyre faktorëve të jashtëm, të cilët ndikojnë negativisht në shëndetin tonë lufton leximi. Leximi ka aftësinë të zhvendosë mendjen tuaj në botën e tij, duke ju bërë të harroni të gjitha problemet e vogla të kaluara gjatë ditës. Koha në të cilën zhyteni në lexim, na ndihmon të kalimisim durimin dhe të forcojmë përqen-

drimin. Këto dy të fundit janë problemet të hasura pafund në ditët tona në një kohë kur përqendrimi largohet vetëm nga një zile e telefonit, ndaj leximi është mënyra më e mirë për të rrit përqendrimin tuaj gjatë përditshmërisë.

5-Leximi të argëton dhe përmirëson humorin

Leximi nuk duhet të konsiderohet si detyrim, mbi të gjitha ai është argëtim. Një libër i mirë mund të largojë çdo pakënaqësi të ditës dhe mes miliona titujve me siguri do gjeni veten diku, shpesh duke lexuar një libër ne gjejmë veten duke buzëqeshur dhe doza e humorit tonë është shtuar për shkak të aktivitetit të trurit dhe adrenalinës së rritur nëpërmes kënaqësisë që të jep leximi..... Në përfundim të këtij shkrimi do ishte lumturi për mua nëse disa prej jush janë frymëzuar dhe fillojnë të investojnë kohën e tyre cilësore për shëndetin e tyre mendor dhe emocional. Libri është: A-Kulturë B-Emocion

\*Doktoreshë shkencash autore lbrash

met botërore të naftës njohën një ulje. Çmimi mesatar për një fuçi naftë ra gati 40% në gjashtë muaj nga pragu i mëparshëm \$ 100. Uljet nën 100 dollarë ishin të rëndësishme. Sipas një numri zyrtarësh rusë, ky burim i ardhurash nga eksportet vlerësohej se ishte i nevojshëm për të mbajtur një buxhet të balancuar. Putin e përkeqësoi problemin e energjisë duke pushtuar dhe aneksuar Krimen dhe Ukrainën, çka ka rezultuar në sanksione ekonomike nga SHBA dhe Europa. Institucionet e mëdha financiare, të tilla si Goldman Sachs, filluan të shpërbanin kapitalin dhe paratë e gatshme nga Rusia. Qeveria ruse u përgjigj me zgjerim agresiv monetar, duke çuar në inflacion të lartë dhe humbje të bankave ruse si dhe në prishje të marrëdhënieve mes tyre. Që nga dhjetori i vitit 2015, kriza financiare dhe ekonomike ruse ishte (dhe mbetet ende) e pazgjidhur. Shumë

ekonomistë parashikonin inflacion të lartë dhe tkurrje në vitin 2016 dhe ashtu ndodhi, veçanërisht pasi marrëdhëniet ruse me Perëndimin vazhdonin të thaheshin kryesisht në eksportet ruse. Pas kësaj ekspozite, **kriza pse ndodhi dhe çfarë solli**, del edhe më në pah përse analiza si problematikë Etike që kryen Nobelisti Joseph Stiglitz, ka qark shumë rëndësi. Është q një vështirësi antropologjike sipas aritmetikës se kudo, në ekonomi, në treg, në banka e bursa, në shtet dhe në shoqëri; vepohet nga njerëz që marrin vendime. Ky akt (vendimmarrja) ka një parashitor sado e gjatë e menduar, apo e befte dhe e shkurtër në kohë qoftë ajo. "Etika-shkruan Stiglitz- mund të ndihmojë në marrjen e vendimeve duke privilegjuar interesa të tilla si p.sh., të bankave ndërkombe tëre apo ato të varfërve." Në ditët tona janë bërë të qarta shumë drejtime të errëta të globalizmit.

Vendet industriale gjatë kësaj dekadë veç të tjerave janë ndeshur dhe me parime bazike të etikës humane, sepse kanë menduar vetëm për interesat e tyre dhe jo të vendeve të zhvillim apo atyre të varfra. Një sjellje e tillë as e zgjidh, as e mban larg krizën. Stiglitz pyet bazuar në etikën: "A mundet të ketë një vështirësi që bashkon interesat dhe rregullon qëndrimin e sjelljen ndaj tyre?" Ai përgjigjet që është e mundur "nëse bashohemi të etika, për të kryer reformat institucionale." "Etika sigurisht në fund të fundit, mbetet një busull jo precize, kumton Stiglitz, por është e vetmja që ofron një orientim, mbas minimal, në një botë në të cilën bëhen shpenzime të mëdha që të shpien në drejtimin e gabuar?"

10 vjet pas krizës...në gjykimin tim(P.Kabo) e vetmja gjë e sigurt është reflektimi. Zgjidhje absolute nuk ka, ashtu si përgjigjes apo fajtorë absolut që ta pohojnë atë nuk

ka...! Ekonomia nuk mundet që e vetme dhe nga vetja t'i zgjidhi të gjitha problemet që ajo i krijon...! Shkenca e ekonomisë, gjithashtu, duhet të ndryshojë shumë çka ka të bëjë me të, që nga konceptimi, filozofia e objektit të saja deri tek raportet me dijet e tjera dhe korridoret e bashkëpunimit, me qëllim largimin nga dogmatizmi dhe aparatit analitik justifikues se në aspektin nominal të gjitha subjektet kanë të drejtë. Ekonomia reale e ka zemrën dhe mekanizmat e shkencës.

(Footnotes)

1 Joseph Stiglitz, *La BUSOLA IMPRECISA-L'ETICA NEL MONDO DELLA FINANZA GLOBALIZZATA*, page 7. *The original title* "Ethics, Market and Government Failure, and Globalization. *Enti botues në versionin italisht CASTELVECCI, MARS 2018.*

2 *Libri cituar...*

## HOROSKOPI

### DASHI

Do të kaloni një ditë shumë interesante, pasi e gjithë vëmendja do të jetë tek ju. Do vendoseni para disa zgjedhjeve, për të cilat do ta keni një aftësi të vështirë të merrni vendimin e duhur. Sa i përket anës romantike, do të mendoni shpesh gjatë ditës për personin tuaj të zëmër.

### DEMI

Bëni të pamundurën për të shmangur stresin. Disa ndryshime në shtëpi do të ndikojnë shumë tek ju, ndaj bisedoni sa më hapur me familjarët. Bëni kujdes kur flisni me partnerin/partneren tuaj pasi mund ta ofendoni.

### BINJAKET

Është koha e duhur për të ndërmarrë një hap të rëndësishëm si martesë. Kjo do ta lumturtojë edhe më shumë marrëdhënien tuaj në çift. Bëni kujdes me shëndetin dhe mos neglizhoni asnjë dyshim lidhur me të.

### GAFORJA

Do të ndihen shumë mirë emocionalisht nëse i ofroni momente të bukura personale rreth jush. Shpërfillini ata që i afrohen vetëm për interes. Sot, disa veprime naive të bashkëshortit/bashkëshortes suaj do t'ua lezojnë ditën.

### LUANI

Gjendja financiare do t'iu përmirësohet pasi do të fitoni disa të ardhura, të cilat nuk i prinit aspak. Mos i neglizhoni këshillat e familjarëve tuaj, sepse vetëm do të përfitonin prej tyre.

### VIRGJERESHA

'Gërmoni' më shumë nëse keni ndërmend të investoni diku. Natyra juaj e mprehtë do të bëjë që të preferoheni nga shumë persona rreth jush. Mund të nisni një marrëdhënie të re romantike, teksa dilni me miqtë në mbremje.

### PESHORJA

Shmangni ushqimet e yndyrshme dhe pikante. Ka gjasa të fitoni më shumë para sot nëse bëni lëvizjet e duhura. Mendohuni mirë para se të ndani një informacion konfidencial me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

### AKREPI

Bëni kujdes se dikush mund t'ju punojë pas krahëve. Tensioni dhe stresi ka gjasa të jenë të pranishme gjatë ditës së sotme. Një event social do të jetë shansi për të përmirësuar marrëdhëniet me disa persona të rëndësishëm.

### SHIGJETARI

Jepini më shumë prioritet problemeve shëndetësore. Nëse i shmangeni një situatë, e cila mund t'ju vërë në siklet, ajo do t'ju ndjekë nga pas gjithë kohës. Do të debatojnë fort me partnerin/partneren tuaj.

### BRICJAPI

Do të kaloni një ditë me emocione të ndryshme, të cilat do t'ju mbajnë nën tension. Megjithatë mos u shqetësoni, sepse do të mbizotërojë ndjenja e kënaqësisë. Ka gjasa partneri/partnerja juaj t'ju befasojë me një surprizë shumë të këndshme.

### UJORI

Stili ekstravagant i jetës suaj mund të shkaktojë tension në shtëpi, kështu që shmangini mbremjet natën vonë dhe tregoni më shumë vëmendje ndaj familjes suaj. Sa i përket çifteve të martuara, do të kaloni një ditë të mrekullueshme.

### PESHQIT

Sot duhet të relaksoheni dhe të përqipeni të gjeni lumturinë mes miqve të afërt dhe të anëtarëve të familjes. Bëni shumë kujdes me financat. Ka gjasa që një prej miqve të mos ju mbështetë në një moment shumë të vështirë.

**Sot Flamurtari-Skënderbeu**

**Shehi: Daja na njeh mirë, përballja me të është e veçantë**

Trajneri i Skënderbeut, Orges Shehi, foli për mediat përpara një takimi të rëndësishëm dhe mjaft të fortë, që pritet të ditën e sotme ndaj Flamurtarit. Ai u shpreh se do të jetë një përballje e veçantë me trajnerin Daja, ndërkohë që kërkon nga



ekipi i tij të njëjtin ritëm si në ndeshjet e fundit. "Është një përballje midis dy rivalëve, pasi kemi edhe të njëjtat pikë në klasifikim. Do të jetë një përballje e fortë. Do ta qua-

ja edhe një miniderbi. E kam thënë dhe e përsëris, në këtë rrugë që jam futur, do kem çdo javë përballje me shokët e mi. Për mua është një ndeshje e veçantë ndaj Dajës. Ai na njeh mirë, por edhe ne e njohim mënyrën e tij të lojës. Gjithsesi, ndeshja ka situata të ndryshme. Unë do kënaqesha nëse skuadra do vazhdonte të luante me grintë dhe me ritëm. Do

futemi në fushë për maksimumin. Kampionati shqiptar është shumë i barabartë, mund të fitosh me të gjitha ekipet, por edhe mund të humbasësh me të gjitha. Është shumë shpejt për të përcaktuar pretendentët, por me fuqinë që kemi dhe me mentalitetin, objektivat janë të qarta." - deklaroi Shehi.

Ze Maria mban premtimin. Tirana gjen fitoren dhe shënon tre gola në portën e Luftëtarit



Jeton Selimi

**Tirana gjen fitoren e parë, Laçi-Partizani në paqe të bardhë**

*Në Kurbin mbyllet gjithçka me shifrat 0-0*

Ze Maria mban fjalën e dhënë. Braziliani kishte parashikuar Tiranën e vërtetë pas javës së tretë. E thënë e bërë. Pas 3 sfidave të para të mbushura me zhgënjim, bardheblutë kanë gjetur golat dhe fitoren ndaj Luftëtarit në përballjen e luajtur në "Selman Stërmasi". Dakord, girokastritët nuk "kafshojnë" dhe kanë pësuar 4 humbje në 4 ndeshje, por sidoqoftë në një luftë nervash, ia dalin të triumfojnë bardheblutë. Dhe këtë e bëjnë duke kaluar fillimisht në epërsi me Blazhevskin, që në minutën e 3-të i shpëton pozicionit jashtëloje dhe mposht Ruçin për epërsinë bardheblu. Epërsi që zgjat vetëm 11 minuta pasi në të 14-ën Doka është i pafat kur devijon roveshatën e Ymerajt, çka kthen sfidën në baraspeshë. Gjithsesi Tirana kërkon më shumë dhe gjen golin e dytë po aq shpejt. Minuta e 24-ët dhe Marvin Turtulli gjendet i lirë në shtyllën e dytë në zhvillimet e një këndoreje për të rikthyer sërish avantazhin bardheblu. Edhe pjesa e dytë ka emocione. Hoxhallari lë Tiranën me 10 vetë në minutën e 55-të pasi merr të verdhën e dytë. Luftëtari



nuk shfrytëzon dot epërsinë numerike, madje u rikthen nderin kryeqytetasve, kur Janiçiq në minutën e 71-të shkon në dhomat e zhveshjes para të tjerëve pasi, gjithashu, ndëshkohet me karton të

kuq. Luftëtari rreket më kot të barazojë, ndërsa Tirana gjen golin e tretë me kundërsulmin e shpejtë që finalizohet nga Greca, për rezultatin përfundimtar 3-1, që rikthen qetësinë në kampin bardhe-

blu. **PARTIZANI NGEC NË LAÇ**  
Laçi dhe Partizani janë ndarë në barazim pa gola në përballjen e luajtur mes tyre pas ditën e së dielës. Kurbin-

asit dhe kryeqytetasit patën mundësi shënimi, por gabimet e sulmuesve dhe pritjet e portierëve mbajtën rrjetat e paprekura deri në fund të ndeshjes. Pjesa e parë është më argëtuese, ndërsa në pjesën e dytë ekipet shpenzojnë shumë energji pa konkretizuar. Gega provon të ndryshojë diçka duke futur Çinarin në vend të Hebajt, por numri 7 ende nuk ka minutat e duhura në këmbë. Mërgjyshi në mungesë të Uzunit, vendos të hedhë Sukajn në fushë. Barazimi bën që si Laçi ashtu edhe Partizani të ndajën nga një pikë, me të kuqtë që ngjiten në kuotën e 7 pikëve, po aq sa Skënderbeu, Flamurtari e Kukësi, ndërsa Laçi mbetet në ndjekje me një pikë më pak.

**SERIE A**



**Strakosha fiton derbin kundër Veselit**

Laçio ka triumfuar në transfertë kundër Empolit, edhe pse me vështirësi 0-1. Golin e vetëm për Laçialët e shënoi Parolo në fillimin e pjesës së dytë (47'). Strakosha luajti titullar për 90 minuta, po ashtu edhe mbrojtësi kuqezi i Empolit, Veseli. Edhe pse jo në rolin e tij natyral, mbrojtësi bëri mirë në të majtë, duke ndaluar shumë aksione të rrezikshme. Veseli u vlerësua shumë pozitivisht nga mediet italiane. Po ashtu, edhe Strakosha bëri disa pritje shpëtimtare. Një mbrëmje pozitive për futbollistët e kombëtares. Në lojë u aktivizua dhe Riza Durmishi, i cili duket se po ambientohet te skuadra e Lacios

**Trajneri shpjegon lënien në stol të kapitenit**

**Ze Maria: Goli na stresoi, tani kam më të mirë se Karabeci**

Trajneri i Tiranës, Ze Maria foli pas ndeshjes kundër Luftëtarit, ku mori një fitore shumë të rëndësishme. Një ndeshje me shumë presion te të dyja skuadrat, por në fund Ze Maria doli triumfues. **E kishit menduar një fitore të tillë me një lojtar më pak?**  
Kisha menduar fitoren, sot e rëndësishme ishte të fitonim ndeshjen, pak rëndësi ka rezultati. **Pamë sërish debutues te Tirana.**  
Imamin e kisha parë në miqësore, dhe kur thashë se pas ndeshjes së tretë do

shihni një Tiranë tjetër, për këtë skuadër me dëshirë e kisha fjalën. Tani duhet të punojmë për ndeshjen me Kukësin. **Stres i madh te ekipi, a mendoni se ka ikur pas kësaj fitoreje?**  
Hoxhallari është një lojtar i rëndësishëm për ne. Skuadra është futur në stres pas golit të shënuar, përpara publikut. Jemi rikthyer të luajmë pas golit të pësuar. I kam thënë skuadrës të luajmë të qetë edhe kur shënojmë, dhe të mos ekzaltohemi. **Sa e vështirë ishte t'i thoshit kapitenit se do ishte në stol?**

Kapiteni është një lojtar serioz dhe profesionist. Kam komunikuar me të, dhe i kam treguar se në futboll duhen bërë disa zgjedhje. Ai do të ketë hapësirat e tij, dhe në këtë moment thjesht u zgjodhën disa të tjerë. **Me rikthimin e Ngos, do ndryshojë faza e sulmit te Tirana?**  
Majkëll është një zgjidhje që e kemi në skuadër. Ai është një lojtar i mirë, dhe bëri mirë sot në sulm. Gjithsesi, në fushë do të jenë ata që janë më në formë. Ngo do të jetë një alternativë më shumë cilësore.

**Portugezi shënoi dy gola**


**Ronaldo: Tani fillon pjesa më e bukur e sezonit**

Vijnë golat te Juventusit për Kristiano Ronaldon dhe natyrshëm që kalon edhe stresi i krijuar këto javë pasi të gjithë kishin filluar të vinin në dyshim aftësinë e portugezitet për të gjetur rrjetat edhe në Itali. Këtë e pranon edhe vetë futbollisti në një prononcim për mediat italiane pas ndeshjes së sotme. "Jam shumë i lumtur për fitoren dhe për golin. Sasuolo ka luajtur shumë mirë, por ne kemi krijuar shumë raste. E gjithë ajo që kishte ndodhur na kishte sjellë pak ankth, duhet të ndihmoj shokët e skuadrës pasi më kanë ndihmuar shumë", tha Ronaldo për mediat italiane. Portugezi pret tani me padurim të zbrësë në fushë në një turne të cilin e njeh mirë si Liga e Kampioneve, të cilën e ka fituar në tre edicionet e fundit dhe sigurisht që bardhezinjtë e kanë afruar pikërisht për këtë. "Tani fillon Liga e Kampioneve, është kompeticioni që më pëlqen më shumë. Grupi është shumë i vështirë, shpresojmë që të kemi edhe pak fat", tha Ronaldo pas ndeshjes së djeshme.





**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. U shkrua nga Zweig.
5. Fillojnë aksionin.
7. Janë për t'u krenrtuar.
13. Sejdini i trinerëve.
15. Ai i Don Kishotit ishte Sanço Pança.
17. Ekstreme në tunel.
18. I ka tek vrapit.
20. Fillojnë andej.
21. Nuk tregohet nga i pasigurti.
26. Luftojnë me pagesë.
27. Inicialet e Gere aktor.
29. Sirena që i dha emrin Napolit.
30. Gjysmë fejeje.
31. E ka simbolin Co në një i tillë.
32. Inicialet e Kazan, regjisor.
33. Turner aktore.
34. Në radhë të parë.
35. As unë as ti.
36. Janë galeri në rrugë.
38. Gibson aktor.

39. Ritet pa zë.
41. Eshhtë edhe ajo e futbollit.
42. Një studio... skulptori.
44. Janë fushat pa fund në veri të Orinkos.
46. Fund shkurti.
47. Fillojnë ideologjinë.
48. Eshhtë materia e trurit.
49. Një është atleti
50. Eshhtë ajo që i ka lënë pas të gjithë.

**VERTIKAL**

1. Eshhtë edhe ajo epizootike.
2. Një është edhe Korabi.
3. I këni në dorë.
4. Eshhtë mbulesë mbi... hambar.
6. Kufijtë e kujtesës.
7. Janë tek në faqe.
8. Kështu përfundon Loreley.
9. Një vend nisjeje.
10. Në këtë moment.
11. Në krye të artistëve.
12. Robbins aktor.
14. Ai i Hekurt ishte Bismarck.
16. Qerohen me... llogari.
19. U shkrua nga Kundera.
21. Eshhtë dhuna me fjalë.
22. Yoko e John Lennon.
23. Një vepër... taumaturgu.
24. Ente Ekonomike Autonomie.
25. Një mund të jetë cirku.
26. Janë indigjenë neozelandezë.
28. Eshhtë edhe ajo gjeografike.
29. Inicialet e Kleopiktur.
30. Ishin formacionet e famshme maqedonase.
33. Eshhtë e zakonshme për pushime
37. Emil piktur.
38. Një planet i Kuq.
40. Një garë në hipodrom.
43. Me të nxjerrin një litër.
45. Qorre pa qe.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

1. Eshhtë trofe sportiv.
3. U hahen... të martuarve.
9. Kufizojnë një truk.
11. Kërcimi i Zorba Grekut.
12. Mund të jenë kohore.
15. Kardashian, aktore dhe modele.
16. Janë përmasa.
17. Eshhtë pjesë e gjuhës.
18. Nafta e Shell.
20. Një i dhjetë në vit.
21. Letra pa zë.
23. Janë qederet, dëmet.
24. Ishin kundërshtarë të babilonasve.
26. Eshhtë llon papagalli.
27. Tregon çmimin me... mirësjellje.
30. Fillojnë ndeshjet.
31. Të parat në stadium.


32. Eshhtë vjelje me... drapë.
34. Opera e Verdi-t.
36. Qe një markë makine.
38. Inicialet e Asimov.
39. Ta... ktheni së prapthi.
40. Një version i FIAT.
41. Eshhtë pelësi.
42. Eshhtë si sobë.

**VERTIKAL**


1. Në krye të kryesisë.
2. Eshhtë shfaqje e parë.
3. Ross këngëtare.
4. Kërkojnë talent të tilla.
5. Të parat në stadium.
6. Një pjesë e makinacioneve.
7. Vrau Hektorin.
8. Roth aktor
9. Qe piktur i famshëm italian.
10. Janë vjedhës.
11. Kompozitori i Sinfonia e dymbëdhjetë
12. Një ciklist në velodrom.
13. Eshhtë e ardhur nga firmat piramidale.
14. Pak diktaturë.
18. Një mund të jetë me... ku-ku.
19. Nota e diapazonit.
21. Masin lëngje të tilla.
22. Janë forma.
23. I vidhet ustait.
25. Eshhtë pjesë telefilmi.
28. Pikas pa ekstreme.
29. Eshhtë ëmbëlsirë me qiri.
31. Umberto poet italian.
33. Dy asa.
34. Kollet por jo kot.
35. Radiotelevizioni i Kosovës.
37. Inicialet e Delon.
39. Fillojnë afërsisht.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËNGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

S	A	A	U	T	O	K	R	I	T	I	K	A	T
A	K	S	I	O	N	E	T	E	K	A	T	R	
R	U	E	P	P	K	A	R	K	R	K	O	A	
A	L	L	P	M	A	L	O	R	E	M	K		
H	E	R	E	M	I	T	I	E	N	T	A	N	I
T	I	R	A	N	E	T	N	D	E	A			
U	A	R	I	K	A	T	E	T	E	T	A	N	I
U	M	I	T	E	T	E	S	T	A	N	I		
K	R	R	E	N	O	L	H	R	D				
K	R	A	T	E	R	P	A	T	A	R	E		
E	S	M	E	R	T	A	L	E	N	T	E	T	
T	A	R	I	T	A	N	A	T	E	M	A	T	
M	A	R	S	H	I	S	A	S	S	P	A		
A	M	I	T	A	K	E	M	I	S	H	A	T	
R	A	S	A	K	A	R	A	N	T	I	N	A	
I	D	I	K	A	P	I	T	A	L	D			
N	O	M	O	N	O	T	O	N	K	I	T		
E	P	I	R	A	T	E	R	I	A	T	O		
S	P	I	T	A	L	E	T	K	R	R	N		
V	E	M	I	L	E	T	E	M	I	L	Y		
A	R	T	E	F	O	N	E	T	I	K	A		
J	O	E	M	I	S	T	E	R	I	E	R		
I	R	O	M	A	K	E	T	M	A	T	A		

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOKU**

8	2				1	4		
	5	3				6		
9					2			
1	9							
2				1	9			
	8			6				
			6			3	7	
			2		4			
5	9		4	7		1		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

4	1	6	2	3	8	5	7	9
5	3	8	7	4	9	1	6	2
2	7	9	5	1	6	3	4	8
6	8	1	3	2	7	9	5	4
7	9	4	8	5	1	2	3	6
3	5	2	9	6	4	7	8	1
9	6	3	4	7	2	8	1	5
1	2	5	6	8	3	4	9	7
8	4	7	1	9	5	6	2	3

*Argëtim filozofik*

- Jam pesimist për shkak të inteligjencës, dhe optimist për shkak të vullnetit.
- Ai nuk harron asgjë, por fal gjithçka.. Atëherë, ai do të urrehet dyfish, sepse shkakton dy herë turp, një herë me kujtesën dhe pastaj me bujarinë e tij.
- Kur të pasurit bëjnë luftë, janë të varfrit ata që vdesin.
- Në botë ekzistojnë dy lojë njerëzish: inteligjentët të pafë dhe fetarët pa inteligjencë.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

7	T	5	4	11		4		1	19	3	13	4	16
12	H	1	5	6	3	10	9	3		11	4	13	6
1	E	13		7	11		4		19	4	7		2
16	S		11	1	5	4	14	15	6	5	3	4	
7	1	5	1	14	18	1	12	3	2	2			
15	1	7	1	13	7	3	19	3		1	13	16	
4	14	1		17	4	14		9	4	7	3	4	
9	6			5	5	3	11	3					19
4	5	5		3	1	4	4	12		3	5		
5	1	4	2		16	1	2	2	1	5	16		
1		18	1	5		4	9	4	14	1	7	3	
7	5	4	13	7	3		4		4	10	3	2	

K	A	D	A	G				G	U	R	I	
D	E	L	I	K	A	T		D	E	T	A	R
K	H	E	R	E	M	I	T	I	O			
H	B	A	J	A	D	E	R	A	E	N		
A	P	T	T	T	T	E		U	M	I		
P	A	M	J	E	T	A	K	A	T	I		
E	L	E	R	E	L	E	K	U	R	A		
S	A	S	T	R	E	E	T	I	A	D		
I	D	E	I	N	A	T	E	R	E	T		
R	I	K	L	E	K	K	A	U	T			
A	N	T	I	K	T	E	J	R	R	E		
T	E	I	E	T	I	M	O	L	O	G		

*Thënie të mënçura*

- Njerëzit janë si bimët: nuk rriten mirë nëse nuk u kushtohet kujdesi i duhur.
- Ekzistojnë shpirtëra të fëlliçur, të brumosur nga llumi i bërllogut, të dashuruar pas fitimit e interesit, po ashtu siç ekzistojnë edhe shpirtëra të bukur, të dashuruar pas lavdisë e virtytit.
- Dallimi në mes "kush jeni" dhe "çfarë doni të jeni" është ajo që bëni për të arritur atë.
- Birra është prova se Perëndia na do dhe dëshiron që të jemi të lumtur.



maiora premunt/ gjëra të mëdha na presin

## ZGJIDH UET NË RAUNDIN E DYTË

5 Diploma Profesionale / 26 Programe Bachelor / 1 Program i Integruar



DP - DIPLOMË PROFESIONALE / BA - BACHELOR / MP - MASTER PROFESIONAL / MSH - MASTER I SHKENCAVE / ME - MASTER EKZEKUTIV / PINT - PROGRAME TË INTEGRUARA / DR - DOKTORATURË

FAKULTETI  
I EKONOMISË BIZNESIT  
DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE  
JURIDIKE, POLITIKE  
DHE MARRËDHËNIEVE  
NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI  
I SHKENCAVE HUMANË  
EDUKIMIT DHE  
ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI  
I INXHINIERISË,  
INFORMATIKËS  
DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI  
I SHKENCAVE  
MJEKËSORE TEKNIKE

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, Cel. 068 20 16 616, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al

